Hyn në fuqi vendimi - - 5 skemat e subvencioneve për bujqësinë nga pagesat direkte 200,000 lekë/ha për serrat, nafta falas dhe subvencionet për herë të parë në peshkim

Faqe 4

Nga 1 marsi do të rriten përsëri çmimet e bulmetit, arsyet

Faqe 5

Skema Kombëtare financon 50% të kostove për certifikimin Global GAP

Faqe 5

KËSHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR
Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit shkurt 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 432
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

FED invest
Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

FINANCIMI GRANT I BE-SË PËR BUJQËSINË PËRMES IPARD II NJË HISTORI SUKSESI

PËRFUNDOI ME SUKSES DISBURSIMI 100 % I FONDEVE GRANT PREJ 94 MILION EURO PËRMES PROGRAMIT IPARD II. PARASHIKOHET RRITJE E NDJESHME E BUXHETIT PËR PROGRAMIN E RI IPARD III NË 146 MILION EURO GRANT

Ecuria e Programit IPARD II dhe pritshmëritë për Programin e ri IPARD III
(Intervistë e Kryetarit të Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj)

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Vodafone Smart Coolers, një tjetër rast *cool* i aplikimit të teknologjisë në bujqësi

Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri

RisiAlbania Partner for Growth

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Faqe 2

GRATË RURALE

"Njerëz të padukshëm", historia frymëzuese e dy pukjaneve për ndihmën e dhënë për gratë e zonave rurale

Faqe 2

STANDARDE NË BUJQËSI

Kujtesë për bujqësinë biologjike

Përgatiti Prof. Ass. Enver ISUFI
Instituti i Bujqësisë Biollogjike, Durrës

Faqe 7

KËNDI I EKSPERTIT

- *Mesazhe për prodhuesit e perimeve* Fq.11
- *Rekomandime për fermerët në lidhje me shërbimet kryesore në pemëtari për javët në vazhdim* Fq.11
- *Plehërimi i agrumeve* Fq.12
- *Kalendari bujqësor, muaji mars 2022* Fq.13

"Të rimbursohet akciza për verën" Shehi: Regjistër cilësie dhe "kufizim" në import!

Industria e verës vendase është në pozita jo të favorshme në krahasim me rajonin, duke bërë që prodhimi të jetë i ulët si dhe tregu të donimonet nga importi. Në një intervistë për TV SCAN, Kreu i Shoqatës...

Faqe 4

STARTUP-et

Të rinjtë interes të angazhohen për startup-et në bujqësi

Faqe 4

RISI ALBANIA

Vodafone Smart Coolers, një tjetër rast *cool* i aplikimit të teknologjisë në bujqësi

Aplikimi me sukses i *Internet of Things* në bujqësi, përmes programit Vodafone *Smart Agriculture*, është një nga investimet më të mëdha që Vodafone Albania ka bërë në tregun shqiptar. Në bashkëpunim me Uka Farm, Vodafone realizoi një projekt pilot që bëri bashkë teknologjinë me bujqësinë, duke i kaluar të gjitha pritshmëritë dhe parashikimet.

Falë zgjidhjeve që ofron *Vodafone Smart Agriculture*, Uka Farm ka arritur të monitorojë mbjelljen, vaditjen, aplikimin e pesticideve, cilësinë e prodhimit, lagështinë e tokës, intensitetin e dritës, deri te vjelja e prodhimit në një mënyrë shumë herë më të shpejtë dhe praktike, falë teknologjisë.

Por IoT është e aplikueshme në të gjithë sektorët e bujqësisë, jo vetëm në fermë. Kështu, ajo është aplikuar me sukses edhe në një tjetër sektor, siç është ai i fabrikave që trajtojnë, ruajnë dhe paketojnë produktet bujqësore. Ndaj, Vodafone Albania ka bashkëpunuar me kompaninë "Doni Fruits", në fabrikën e të cilit ka aplikuar *smart coolers*, një aplikacion i vendosur në frigoriferët e fabrikës, për të monitoruar temperaturën dhe lagështinë.

Që frutat dhe perimet të përmbushin kriteret për treg, por sidomos për eksport, kërkohet një nivel maksimal kujdesi e kontrolli, që "Doni fruits" e ka arritur falë *Vodafone Smart Coolers*. Përmes mbikëqyrjes së dhomave frigoriferike, ky aplikacion arrin të kontrollojë dhe ruajë lagështinë, të

monitorojë sa herë hapet dera e frigoriferit dhe të sinjalizojë në raste ndodhish të pakëndshme, që mund të dëmtojnë produktin. Për shembull, nëse temperatura në dhomën frigoriferike rritet, personi përgjegjës për këtë proces merr mesazhin se dera e frigoriferit është hapur dhe temperatura është rritur me x gradë. Sa më i shpejtë dhe i saktë të jetë ky informacion, aq më të mëdha mundësitë për të reaguar dhe zgjidhur problemin, duke ruajtur kësisoj cilësinë e produkteve.

"Pasi ramë në kontakt me *Vodafone Smart Agriculture*, ne vendosëm menjëherë ta instalojmë *smart agriculture* në sektorin e prodhimit, si dhe në qendrën tonë të grumbullimit në qytetin e Lushnjes. Jemi kompania e parë në Shqipëri që kemi aplikuar këtë teknologji në këtë industri, duke u përshprehet Ejup Ahmeti, administrator i "Doni Fruits".

Smart Agriculture ndihmon jo vetëm në kryerjen e disa proceseve, por rrit gjithashtu efikasitetin dhe ul kostot, e gjitha kjo përmes një aplikacioni në telefonin, tabletin apo kompjuterin tuaj.

Përmes *Vodafone Smart Agriculture*, fermerët mund pjekur të sjellim standardin evropian në Shqipëri. Jemi të lumtur që kemi një partner vendor, por me produkte inovative ndërkombëtare, si Vodafone. Ne tashmë kemi implementuar disa produkte *smart* dhe po përgatitemi të implementojmë të tjera gjatë vitit 2022", të ndërtojnë ferma dhe fabrika përpunimi inteligjente, ku gjithë proceset e prodhimit mund të dixhitalizohen. Sipas organizatës së ushqimit dhe bujqësisë, në vitin 2050 në Shqipëri, do të duhet të prodhohet 50-100% më shumë ushqim se ç'është prodhuar deri më sot, duke garantuar krahas sasisë edhe cilësinë. Dhe teknologjia IoT do të jetë aty për të lehtësuar këtë proces intensiv, siç është në çdo fushë tjetër të jetës. Rasti i "Uka Farm" dhe "Doni Fruits" është shpresëdhënës për Vodafone Group dhe Vodafone Albania se në të ardhmen fermat dhe fabrikat në Shqipëri e në të gjithë Europën do të jenë më *smart.*

Por IoT është e aplikueshme në të gjithë sektorët e bujqësisë, jo vetëm në fermë. Kështu, ajo është aplikuar me sukses edhe në një tjetër sektor, siç është ai i fabrikave që trajtojnë, ruajnë dhe paketojnë produktet bujqësore. Ndaj, Vodafone Albania ka bashkëpunuar me kompaninë "Doni Fruits", në fabrikën e të cilit ka aplikuar* smart coolers*, një aplikacion i vendosur në frigoriferët e fabrikës, për të monitoruar temperaturën dhe lagështinë.

***Që frutat dhe perimet të përmbushin kriteret për treg, por sidomos për eksport, kërkohet një nivel maksimal kujdesi e kontrolli, që "Doni fruits" e ka arritur falë* Vodafone Smart Coolers.**

"Njerëz të padukshëm", historia frymëzuese e dy pukjaneve për ndihmën e dhënë për gratë e zonave rurale

"Njerëz të Padukshëm" është rubrika që sjell historitë frymëzuese të mësueses Dake Gjoni dhe të 24-vjeçares Alida Çobaj, për ndihmën që kanë dhënë për gratë e Pukës dhe të zonave rurale të qytetit verior.

Mësuesja Dake Gjoni rrëfen për profesionin e saj si mësuese biologjie dhe kimie, si dhe angazhimin e saj në shoqatën "Agro Puka". Ajo ngriti një grup grash që merren me përpunimin e frutave dhe prej 15 vitesh ato tashmë janë në treg me produktet e tyre.

"Unë jam rritur në fshatin Buhot të rrethit të Pukës në një familje të thjeshtë punëtorësh, por me shumë vlera. Ajo çfarë unë dua të veçoj nga prindërit e mi është se më kanë edukuar me dëshirën për shkollën, por edhe për punën, gjë të cilën unë përpiqem ta transmetoj edhe tek fëmijët e mi. Jam nënë e katër djemve, kam dhe bashkëshortin, falë të cilit jam personi që jam. Kemi ecur shumë përpara dhe ia kemi dalë me gjithë kërkesat e nevojat që kanë pasur fëmijët duke u integruar në rrugën e shkollimit", – thekson Gjoni.

E gjithë zona e thërret në shtëpi, apo kudo mësuese Dakja.

"Kam mbaruar universitetin e dytë në degën biologji-kimi

dhe aktualisht jam mësuese në ciklin 9-vjeçar në shkollën "8 Dhjetori" Qelëz. Të jesh mësuese është një ndjesi shumë e bukur, sepse gjithmonë mbetesh e re dhe nuk e kupton se vitet kalojnë", – shprehet ajo.

Mësuese Dakja tregon se u lidh shumë me fshatin dhe bimët.

"Një prej objektivave të mi është që të ushqehen mirë edhe fëmijët që të rendin pas ushqimeve bio dhe natyrale. Përveç punës si mësuese në shkollën 9 vjeçare në Qelëz duke qenë në profesion agronome jam anëtarësuar në shoqatën "Agro Puka". Duke parë mënyrën sesi operohej me grupe grash pranë kësaj shoqate më lindi ideja edhe në komunitetin ku unë banoj të ngre një grup grash. Në fillim ne u morën me përpunimin e frutave, jemi bërë pjesë e panaireve jo vetëm unë, por edhe një pjesë e mirë e grupit të grave. Në fillim ishte shumë e vështirë duke thyer një tabu se gratë nuk dilnin në treg. Por jemi këtu prej 15 viteve", – nënvizon ajo.

Mësuese Dakja tregon se ka punuar dhe ka fituar. "Jam ndjerë shumë mirë, thotë ajo, angazhimi im përveç se është burim i mirë i të mirave materiale ka edhe vlera morale, sepse shërben si model për shoqet tona dhe brezin e ri, për fëmijët tanë që përveç profesionit kemi edhe angazhime të tjera në komunitet. Është një detyrë e rëndësishme për të shërbyer si një shembull për familje të tjera kryesisht në zonat rurale ku gratë në përgjithësi pas viteve '90 lanë mbetur të izoluara pranë familjeve duke punuar në tokën e tyre".

Alida Çobaj, 24 vjeçe tregon: "Kam studiuar në Tiranë për tre vite arkeologji më pas jam larguar për në Amerikë ku kam punuar dhe kam jetuar për një periudhë 6-mujore, kam punuar punë të ndryshme. Pastaj zgjodha të kthehem dhe të mos shkoj më në Amerikë se kam familjen këtu dhe është ajo që më bën mua të jem sot kjo që jam".

"Ushqimi nuk është thjesht të serviret në tavolinë, por të dish edhe procesin sesi të vjen i gjithi në pjatë. Prodhojmë dhe shesim qoftë për fshatin për ata që kanë nevojë, por edhe për tregun në qytetin e Pukës", – thekson Çobaj.

Gjithë jetën time, vijon ajo, kam jetuar në pallat edhe tek toka këtu, kam qenë pjesë edhe e fshatit edhe qytetit, si dhe i dua shumë kafshët, të gjitha.

Çobaj, e cila punon edhe si koordinatore për barazinë gjinore thotë se "janë 100 gra që janë aktive në grupet e grave. Më pëlqen shumë fakti që më shohin si një pikë, e cila mund t'u japë diçka ndryshe, u sjell një frymë ndryshe. Gratë duhet të rrisin breza të rinj me ide të reja. Vajzat janë burrat e vetes, kjo është ideja që unë mundohem t'u jap grave në zonën e Pukës dhe në zonat rurale".

STAFI I GAZETES

Kryetar i Bordit të Gazetës: Agim Rrapaj; **Bordi Drejtues: Zana Konini, Edmond Gjata, Shkëlqim Agolli, Ago Nezha, Enida Shena,**
Design & Layout: Elvira Çako Çeku; Asistente: Rozi Martini; Adresa: Rr."Mine Peza", P. 87/3, Hyrja 2, Kati 1, **Tel./ Fax**: ++ 355 4 2229445:
Web site: www.kashalbania.org E-mail: infokash@yahoo.com Llog. Bank.: TIRANA. BANK: AL092061100400001003018261000; INTESA: AL752081100800000010232318 03

PROJEKTI I BE-së

FINANCIMI GRANT I BE-SË PËR BUJQËSINË PËRMES IPARD II NJË HISTORI SUKSESI

PËRFUNDOI ME SUKSES DISBURSIMI 100 % I FONDEVE GRANT PREJ 94 MILION EURO PËRMES PROGRAMIT IPARD II. PARASHIKOHET RRITJE E NDJESHME E BUXHETIT PËR PROGRAMIN E RI IPARD III NË 146 MILION EURO GRANT

Ecuria e Programit IPARD II dhe pritshmëritë për Programin e ri IPARD III
(Intervistë e Kryetarit të Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj)

Cilat janë qëllimet dhe objektivat e programit IPARD?

• Të rritet siguria ushqimore dhe aftësia e sektorit agro-ushqimor për të përballuar presionin e konkurrencës, si dhe për të përafruar progresivisht sektorin me standardet e BE, veçanërisht ato që lidhen me higjienën dhe mjedisin;

• Të sigurojë mbështetje për investime përmes sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit që janë në përputhje me standardet e mirëqeverisjes të një administrate publike moderne ekuivalente me ato në organizata të ngjashme në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian;

• Nxitja e punësimit përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe mbajtja e vendeve ekzistuese, përmes zhvillimit të aktiviteteve shtesë të biznesit, duke rritur kështu nivelin e aktivitetit ekonomik të zonave rurale dhe duke përmbysur shpopullimin rural.

• Të rritet efikasiteti, konkurrenca dhe prodhimi i qëndrueshëm bujqësor në sektorin agro-ushqimor, duke arritur në mënyrë progresive standardet e Bashkimit Evropian, rritur pozicionin e fermerëve në zinxhirin ushqimor dhe duke mbështetur fermerët e rinj.

• Për të përmirësuar përgjigjen e sektorit agro-ushqimor ndaj kërkesës së publikut për ushqim me cilësi të lartë, të sigurt, ushqyese dhe të qëndrueshme, si dhe mirëqenien e kafshëve.

• Të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike, si dhe energjinë e qëndrueshme dhe të nxisë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tilla si uji, toka dhe ajri.

• Objektivi i përgjithshëm është të mbështesë zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, duke çuar në një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse përmes zhvillimit të infrastrukturës fizike;

• Lehtëson zhvillimin e biznesit dhe komunitetit, në zhvillimin dhe punësimin në zonat rurale.

Sa e ndihmon IPARD fermerin shqiptar?

Fermerë të rregjistruar në Shqipëri janë rreth 354 mijë dhe mund të ndahen e klasifikohen në tre kategori.

- Kategoria e fermerëve të pavarur që prodhon për konsum vetiak dhe të blegtorisë që mbarshton,

- Kategori që prodhon për konsum vetiak, për blegtorine e vet dhe i mbetet një tepricë prodhimesh për tregun vendas.

- Kategori e tretë janë fermerë dhe subjekte të formalizuar, që prodhojnë kryesisht për tregun e vendit dhe për eksport.

Grupimi parë dhe i dytë nuk ka mundësi të përfitojë drejtpërdrejt nga Programi IPARD. Këto dy grupime përbëjnë rreth 82 % të fermerëve të rregjistruar në Shqipëri. Mundet të përfitojnë drejtpërdrejt vetëm grupimi ose kategoria prej 18 % e fermerëve dhe subjekteve të cilët presupozohet të jenë të formalizuar dhe të plotësojnë disa kushte jo të lehta për ta për tu kualifikuar dhe shpallur fitues.

Sa % të fondeve IPARD II kemi disbursuar dhe sa parashikohen për IPARD III?

Programi IPARD II është miratuar në Shumën 94 milion euro në vitin 2014. Nga viti 2014 deri ne 2017 disbursimi ka qenë zero. Nga 2018 – 2021 janë disbursuar dhe janë në proces disbursimi në thirrjen e katërt që u mbyll në datën 25 shkurt e gjithë sasia e fondeve të programuara.

Shqipëria është i vetmi vend në rajon që ka mundur të disbursojë 100 % të fondeve IPARD. Ky konsiderohet një sukses që ka shërbyer si bazë për BE dhe Qeverinë shqiptare për rritjen e ndjeshme të sasisë së fondeve në 146 milion euro të programuara per IPARD III, që parashikohet të hapet gjatë vitit 2022.

Sa transparent është programi IPARD?

Programi teorikisht është ndërtuar që të funksionojë me transparencë dhe për fat të mirë në Shqipëri po rezulton i tillë. Zbatimi kritereve të transparencës në praktikë është një proces i vështirë. Por duhet thënë që strukturat e BE, mediat, KASH, shoqëria civile i ka kushtuar rëndësi të madhe monitorimit të këtij programi. AZHBR mundësoi aplikimin e përfituesve në mënyrë elektronike. Gjithashtu dhe një pjesë e mirë e vlerësimit të dosjeve bëhet përmes një programi elektronik, i cili lë gjurmë dhe ndihmon e lehtëson shumë procesin e kontrollit dhe monitorimit. Procesi i kontrollit në terren është procesi më i vështirë, por deri tani ka rezultuar efiçent. AZHBR mbas vitit 2018 ndryshoi pozitivisht gjithë veprimtarinë e vet dhe falë përpjekjeve të mëdha arriti që të fitojë jo vetëm besimin e strukturave të BE, por edhe të komunitetit të fermerëve të cilët bazuar edhe tek ky fakt kanë aplikuar masivisht dhe kërkesat kanë rezultuar më shumë se sa fondet që kanë qenë në dispozicion.

Cilat kanë qenë problemet e IPARD?

Problemet kryesore kanë qenë:

1. Vonesa e tejzgjatur e procesit për periudhën e kualifikimit, si dhe për periudhën nga momenti përgjigjes që je shpallur fitues deri në momentin që fondet kalojnë në llogarinë e përfituesit. Vonesë që dëmton efiçencën e veprimtarisë së përfituesit.

2. Probleme kemi patur me prioritetet e kufizuara të financimit dhe për rrjedhojë numrin e kufizuar të përfitуesve nga të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor.

3. Nuk ka një program të qartë dhe konkret koordinimi institucional për financimin e të gjithë sektorëve, ku të koordinohet e përcaktohet saktë sasia e financimit, për të gjitha hallkat e zinxhirit që përbëjnë atë të cilën Ne e quajmë "Ekonominë e Ushqimit". Unë këtu kam parasysh sektor si atë të: Bujqësisë, "Blegtorisë", "Peshkimit dhe Akuakulturës", "Agrobiznesit", "Agropërpunimit", "Bimëve Mjeksore, Aromatike dhe Bletarisë", "Agroturizmit, Agropylltarisë dhe Mjedisit në zonat rurale", "Tregjeve Agro-Blegtorale", "Financës, Mikrofinacës dhe përmirësimit të legjislacionit që impakton Zonat Rurale".

Shumë nga hallkat e sipërcituara te cilat nuk janë mbështetur nga IPARD shpesh kanë krijuar probleme në funksionimin normal dhe efiçent të këtij zinxhiri. Mosfunksionimi normal i të gjithë zinxhirit ushqimor krijon probleme në veprimtarinë e sektorit privat që operon në fushën e Ekonomisë së Ushqimit.

4. Hapja me vonesë e mases 4 dhe 5, të cilat kanë të bëjnë me procesin "LEADER" dhe Asistencës Teknike në programin IPARD ka qenë një tjetër mangësi që influencon negativisht në procesin e efiçencës se investimeve dhe disbursimit të fondeve.

5. Asistenca ndaj ekspertëve dhe studiove që përpilojnë dosjet për aplikim në programin IPARD dhe fondet e programuara për kualifikimin e tyre ka qenë e pamjaftueshme.

Çfarë mund të përmirësohet në të ardhmen tek IPARD?

Duhen futur pa humbur kohë në rrugën e zgjidhjes të gjitha problemet që i trajtova pak më lart.

A mund të na jepni një informacion më të detajuar për Programin IPARD III?

Pritshmëritë për Programin IPARD III janë shumë më të mëdha nga ana jonë. Besojmë që sukseset e arritura nga IPARD II do të çohen më tej nga IPARD III.

Po ju informoj në mënyrë të përmbledhur edhe për qëllimin dhe objektivat e Progarmit IPARD III.

Objektivat e Përgjithshme

• Të rritet siguria ushqimore dhe aftësia e sektorit agro-ushqimor për të përballuar presionin e konkurrencës, si dhe për të përafruar progresivisht sektorin me standardet e BE, veçanërisht ato që lidhen me higjienën dhe mjedisin;

• Të sigurojë mbështetje për investime përmes sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit që janë në përputhje me standardet e mirëqeverisjes të një administrate publike moderne ekuivalente me ato në organizata të ngjashme në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian;

• Nxitja e punësimit përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe mbajtja e vendeve ekzistuese, përmes zhvillimit të aktiviteteve shtesë të biznesit, duke rritur kështu nivelin e aktivitetit ekonomik të zonave rurale dhe duke përmbysur shpopullimin rural.

Objektivat Specifike

Në përputhje me Objektivat specifike të IPA-s:

• Reforma e administratës publike dhe mirëqeverisja

• Promovimi i barazisë gjinore;

• Zhvillimi i shoqërisë civile dhe dialogut social;

• Mbështetje për zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, përfshirë

• Nxitjen e punësimit dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe

• Zhvillimin e kapitalit fizik

• Arritja progresive me standardet/acquis të BE - forcimi i aftësisë për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi

Buxheti paraprak

• Akordimet e fondeve nga 2021 deri në 2027, në varësi të disponueshmërisë së fondeve pas aprovimit të buxheteve vjetore;

• Fondet duhet të përdoren brenda 3 viteve nga viti I angazhimit (rregulli n + 3)

Vitet	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2021-2027
Total I Milion Euro	8	10	12	16	19	23	24	112

Mënyra e Menaxhimit

• Menaxhim indirekt pa kontrolle ex-ante nga Delegacioni / Komisioni i BE-së pas akreditimit sipas masave

• Dhënja e granteve për projektet e Fermerëve dhe NVM-të në sektorin agro-ushqimor,

• Nëpërmjet (Agjencia IPARD) për të përzgjedhur, kontraktuar dhe paguar projektet pasi të sigurohet që ky organ është në gjendje të menaxhojë siç duhet fondet e BE-së;

• Përzgjedhja e masave, monitorimi i programit, publiciteti, vlerësimi dhe raportimi bëhet nga Autoriteti Menaxhues

Situata në vend

• Sipërfaqja 28.7 mijë km2, popullsia – 2.8 milion banorë

• Sektori bujqësor (me pylltari dhe peshkim) - 20.6% e vlerës së shtuar bruto, 51% e punësimit total në sektorin agro-ushqimor

• Sektori nuk përputhet me standardet minimale të BE-teknologji e vjetëruar në prodhimin bujqësor dhe përpunimin e ushqimit;

• Konkurrencë e ulët;

• Numër i lartë i fermave (madhësia mesatare e fermës - 1,2 ha) Papunësia e lartë

• Të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike, si dhe energjinë e qëndrueshme dhe të nxisë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tilla si uji, toka dhe ajri.

Sektorët

• Sektori i mishit;

• Sektori i qumështit;

• Sektori i frutave dhe perimeve;

• Sektori i verës dhe;

• Bimët medicinale dhe aromatike

Standardet dhe kriteret

• Duhet të jetë në përputhje me standardet e BE-së në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e kafshëve

• Prioriteti në investime:

• Në zonat malore;

• Lidhur me ruajtjen, trajtimin dhe trajtimin e plehut organik;

• Në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;

• Bërë nga aplikantët që praktikojnë bujqësinë organike;

• Bërë nga fermerë të rinj (<40) dhe gra;

• Bërë nga shoqatat e bashkëpunimit bujqësor

Plani Financiar 2021-2027

Masat	Totali i mbështetjes Publike (EUR)	Kontributi i BE (EUR)	Kontributi i BE (%)	Kontributi Kombëtar(EUR)	Kontributi kombëtar(%)
Investimet në asete fizike të fermave bujqësore	41,973,333	31,480,000	75%	10,493,333	25%
Investimet në asete fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të	40,480,000	30,360,000	75%	10,120,000	25%
Masa Agro-ambjentale dhe bujqësia organike	2,528,235	2,149,000	85%	379,235	15%
Zbatimi i strategjive lokale të zhvillimit - qasja LEADER	4,800,000	4,320,000	90%	480,000	10%
Zbatimi në Infrastrukturën Publike Rurale	16,000,000	12,000,000	75%	4,000,000	25%
Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit	28,434,667	21,326,000	75%	7,108,667	25%
Asistenca Teknike	2,235,294	1,900,000	85%	335,294	15%
Shërbimi Ekstensiv	2,900,000	2,465,000	85%	435,000	15%
Pyjet	7,058,824	6,000,000	85%	1,058,824	15%
Total	**146,410,353**	**112,000,000**		**34,410,353**	

Investimet në asete fizike të fermave bujqësore

• Të rritet efikasiteti, konkurrenca dhe prodhimi i qëndrueshëm bujqësor në sektorin agro-ushqimor, duke arritur në mënyrë progresive standardet e Bashkimit Evropian, rritur pozicionin e fermerëve në zinxhirin ushqimor dhe duke mbështetur fermerët e rinj.

• Për të përmirësuar përgjigjen e sektorit agro-ushqimor ndaj kërkesës së publikut për ushqim me cilësi të lartë, të sigurt, ushqyese dhe të qëndrueshme, si dhe mirëqenien e

Investimet në asete fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit

• Të rrisë konkurrencën në sektorin agro-ushqimor, për të përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e prodhimit në fermë, duke siguruar një përgjigje më të mirë të sektorit të ushqimit ndaj kërkesave të konsumatorëve për ushqim të shëndetshëm, të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, në përputhje me standardet përkatëse të BE-së.

• Të ndihmojë në adresimin e sfidës së ndryshimit të klimës, duke promovuar

(Vijon në faqen 7)

SKEMA KOMBËTARE

Hyn në fuqi vendimi - 5 skemat e subvencioneve për bujqësinë nga pagesat direkte 200,000 lekë/ha për serrat, nafta falas dhe subvencionet për herë të parë në peshkim

5 skema subvencionesh në ndihmë të bujqësisë do të zbatohen këtë vit, duke nisur nga mbështetja e prodhimit në serra, peshkimit, vazhdimi i skemës të naftës për rimbursimin e taksave, ndërtimin e tregjeve për kafshët e gjalla dhe dixhitalizimin e bujqësisë.

Vendimi i Ministrisë të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i botuar në Fletoren Zyrtare përcakton se për fermerët e serrave subvencionet do të jenë në formën e pagesave direkte që nisin nga 200,000 lekë/ha për 2 sezone të mbjellash për kultivimin e perimeve, rrushit të tavolinës dhe luleshtrydheve.

Mbështetja ndaj fermerëve të serrave do të mbulojë shtimin e kostove nga çmimet e larta të inputeve bujqësore në tregjet ndërkombëtare të lidhura me krizën energjetike. Në propozimin e saj fillestar dërguar Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kërkoi subvencione me vlerë 300,000 lekë/ha.

Vitin e kaluar u zbatua për herë të parë skema e mbështetjes me naftë falas për fermerët që do të vijojë zbatimin edhe këtë vit, duke përfshirë për herë të parë rimbursimin e akcizës dhe taksës të qarkullimit për fermerët që kultivojnë dru frutorë, arrorë dhe perime. Shteti subvencionin 80,4 lekë nga çmimi i naftës që përfshin akcizën, taksën e qarkullimit, karbonit dhe TVSH-në.

Për herë të këtë vit do të aplikohet edhe skema me subvencione për sektorin e peshkimit. Për rinovimin e anijes të peshkimit do të rimbursohet nga shteti 50% e totalit të investimit por jo më shumë se 20 mln lekë. Për rinovimin infrastrukturës së anijes së peshkimit. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore të blerjes, por jo më shumë se 7,250, 000 lekë.

SKEMAT E SUBVENCIONIMIT

Serra

a) Mbështetje për fara/fidanë dhe input-e të tjera me 200,000 (dyqind mijë) lekë për ha për sezon dhe jo për më shumë se 2 sezone, për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermerë individualë ose grupfermerësh, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për aplikant.

b) Për ndërtimin e serrave diellore të reja për prodhimin e perimeve me sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 5 (pesë) ha për subjekt, përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë për ha.

c) Mbështetje për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë/ha, për fermerë individualë ose grup-fermerësh, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha, por jo më shumë se 1,000,000 (një milion) lekë për aplikant.

ç) Fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë, 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, vitin e tretë 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) për fermë të certifikuar.

d) Implementimi dhe certifikimi global GAP, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore:

i. por jo më shumë 175,000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, në sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha;

ii. por jo më shumë se 500,000 (pesëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 ha në fushë të hapur.

Blegtoria dhe peshkimi

Për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermat me jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë, por jo më shumë se 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për subjekt, ndërsa për fermat me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë lopë, në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt.

a) Mbarështim i bletarisë me 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje, por jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë) mijë lekë për subjekt.

b) Për blerjen e anijeve të peshkimit tregtar profesional, që zëvendësojnë anijet ekzistuese.

Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore të blerjes, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt peshkimi, në rastet e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b", të pikës 11, të nenit 30, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin" të ndryshuar.

c) Për rinovimin infrastrukturës së anijes së peshkimit. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore të blerjes, por jo më shumë se 7,250, 000 lekë për anije peshkimi të pajisur me leje të vlefshme peshkimi tregtar dhe jo më shumë se 20,000,000 lekë për subjekt.

Rinovimi i anijes së peshkimit përfshin: i. blerjen dhe instalimin e motorit kryesor, por jo më shumë se 4,000,000 lekë; ii. blerjen dhe instalimin e motorit ndihmës (gjeneratori detar), por jo më shumë se 2 000 000 (dy milionë) lekë; iii. blerjen dhe instalimin e vinçit të anijes, por jo më shumë se 1,250,000 lekë.

Naftë për bujqësinë

Mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi, në vlerën deri në 950,000,000 lekë. Subjektet përfituese mbështeten me sasi nafte falas në barasvlerë të lehtësimit fiskal të naftës që përdoret për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, sipas kritereve dhe masës së përfitimit, të përcaktuara në këtë vendim.

Kulturat bujqësore/grup-kulturat, normativat e konsumit të naftës dhe sasia përkatëse e naftës që përfitohet falas janë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është me burim informacioni Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Subjektet përfituese duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës;

b) madhësia totale e fermës duhet të jetë me sipërfaqe jo më pak se 0.4 ha, ndërsa madhësia e parcelave me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha.

– Aplikimi për të përfituar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë bëhet online në portalin e-Albania, me vetëdeklarim. Përfitimi i sasisë së naftës falas për sipërfaqen që kultivohet, është, si më poshtë vijon:

a) 100% e sasisë për subjektet me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përllogaritjeve të bëra referuar aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) subjektet me sipërfaqe mbi 10 ha, për sipërfaqen deri në 10 ha, përfitojnë sasitë sipas përcaktimit të shkronjës "a" të kësaj pike, ndërsa për pjesën tjetër mbi 10 ha përfitojnë sasinë e naftës me normativë të reduktuar.

Normativa e reduktuar përllogaritet bazuar në nevojat për naftë të subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha, por jo më shumë se normativa e lejuar, si dhe në sasinë e mbetur të naftës në dispozicion, pasi janë plotësuar nevojat deri në 10 ha të gjitha subjekteve, që janë kualifikuar si përfitues pjesë përbërëse e tij.

Si çmim referencë për naftën do të merret çmimi i botuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i Agjencisë së Prokurimit Publik, nr. 5, datë 7.2.2022 (rubrika "Të dhëna për karburantet")

Tregje të produkteve bujqësore dhe të kafshëve të gjalla

Mbështetje për ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore dhe/ose tregjeve të kafshëve të gjalla për shoqëritë aksionare me kapital 100% shtetëror, në vlerën jo më shumë se 30,000,000 lekë, nëpërmjet transferimit të fondit nga llogaria ekonomike 606 në llogarinë ekonomike 604 "Të tjera transferta të brendshme".

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) ekzekuton transferimin e fondit përkatës te bashkia përkatëse, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e këtij fondi.

Inovacione dhe digjitalizim në bujqësi

a) Mbështetje për ngritjen e një skeme kombëtare trajnimi në bujqësi dhe ngritjen e Qendrës së Ekselencës dhe Inovacionit të Sistemeve Prodhuese, në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), në bashkëpunim me një nga universitetet evropiane, në vlerën deri në 50,000,000 lekë, nëpërmjet transferimit të fondit nga llogaria ekonomike 606 në llogarinë ekonomike 604 "Të tjera transferta të brendshme". AZHBR-ja ekzekuton transferimin e fondit përkatës tek UBT-ja, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e këtij fondi.

b) Mbështetje për automatizimin dhe digjitalizimin e proceseve të punës në fermë. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1,000,000 lekë për subjekt.

"Të rimbursohet akciza për verën" - Shehi: Regjistër cilësie dhe "kufizim" në import!

Industria e verës vendase është në pozita jo të favorshme në krahasim me rajonin, duke bërë që prodhimi të jetë i ulët si dhe tregu të donimonet nga importi. Në një intervistë për TV SCAN, Kreu i Shoqatës së Prodhuesve të Verës Familjare, Gazmend Shehi, shprehet se kantinat kanë nevojë për incentiva fiskale, që të jenë më konkurrese.

Nga ana tjetër, Shehi shprehet se ka nevojë për disa kufizime sa i takon importit të verës, pasi ka konkurrencë të pandershme.

Shehi sugjeron gjithashtu që të ngrihet një institucion për të bërë kalsifikimin e verërave dhe orgjinën e tyre, në mënyrë që konsumatorët të mos kenë paragjykime për cilësinë.

Aktualisht në komisione parlamentare po diskutohet projektligji për vreshtarinë dhe verën i cili synon të ndërhyjë per rregullimin e industrisë dhe rritjen e aksesit të prodhuesve shqiptarë në treg.

Prodhuesit e verës kërkojnë rimbursimin e akcisës në mënyrë që të favorizohet prodhimi vendas si dhe vendosje të kufizimeve në import. Propozimet jepen në një kohë kur po diskutohet ligji për vreshtarinë dhe verën.

Të rinjtë interes të angazhohen për startup-et në bujqësi

Digjitalizimi i bujqësisë është një ndër faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm dhe inovacionin në këtë sektor.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural synon të bashkëpunojë me donatorë për zbatimin e programeve që nxisin të rinjtë të zhvillojnë ide inovative në sektorin rural. Për ët nxitur këtë proces, projekti RisiAlbania përmes zyrës së Këshillimit të Karrierës po kontribuon duke orjentuar të rinjtë rreth profesioneve te larmishme që ata mund të kryejnë në të ardhmen duke i ndihmuar kështu me zgjedhjen e tyre të studimit, ku padyshim vend kryesor zë edhe studimi në fushën e bujqësisë.

Ndërkohë një programi të ri, është "AgriChallenge" që bashkon 100 studentë të bujqësisë, fermerë të rinj nga rajoni i Korçës, për të gjeneruar dhe zbatuar ide të reja në fushën e Startup-e.

Zv.ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Enio Civici në prezantimin e këtij programi tha se, "ky është një konkurs inovator që bën bashkë 100 të rinj të apasionuar ndaj teknologjisë dhe bujqësisë, me pasionin për zbatimin e ideve të tyre në Startups".

Sipas tij, përmes digjitalizimit të bujqësisë synohet të shkohet drejt çdo burimi informacioni që kemi në lidhje me bujqësinë, duke adresuar nevoja bazë që i shërbejnë gjithë komunitetit, konkurrueshmërisë dhe nxitjes së eksporteve.

Vitet e fundit fermerët kanë shtuar kërkesat për informacion në fushën e inovacionit dhe start-up pranë Qendrave të Transferimit të Teknologjisë Bujqësore. Kjo për faktin se, gjithnjë e më shumë po synohet që prodhimi bujqësor vendas të orientohet drejt eksporteve.

"Ndaj dhe programi i ri synon të nxisë startup-et në sektorin e bujqësisë, për rajonin e Korçës që spikat për potenciale të larta të prodhimit dhe eksportit bujqësor", tha Civici.

Në këtë aktivitet u prezantuan disa shembuj konkret në fushën e Startup-ve në bujqësi.

Në fazë të parë projekti ka bërë një studim mbi nevojat e bujqësisë në rajonin e Korçës dhe parashikon që këtyre nevoja të rinjtë t'ju përgjigjen me zgjidhje inovative.

Përfaqësues të programit për Zhvillimin e Qëndrueshëm Rural u shprehën se, "Shqipëria duke përfshirë edhe Korçën, është pjesë e ndryshimeve të mëdha që po ndodhin në të gjitha nivelet përfshirë edhe atë ekologjik dhe kjo është arsyeja që Qeveria Gjermane po mbështet zhvillimin e qëndrueshëm rural".

Ata ftuan të gjithë të rinjtë të bëhen pjesë e këtij projekti që nis zbatimin për herë të parë në qytetin e Korçës, për tu bërë shembull edhe në rajone të tjera të vendit.

TEMA TË DITËS

Të shpëtojmë bujqësinë

Jo gjithnjë të jesh i madh do të thotë se ke avantazh. Shembulli më i mirë në vend është bujqësia. Sipas Eurostat, pesha e bujqësisë në vlerën e shtuar bruto të ekonomisë në vend, në vitin 2020, ishte 21.8%, shumë më e lartë se Maqedonia e Veriut (e dyta pas nesh) dhe mesatarja e Bashkimit Europian prej 1.6%.

Në kontrast, mbështetja e buxhetit për bujqësinë është shumë e ulët (të dhënat e OECD-së në vitin 2018 tregojnë se mbështetja për hektarë në Shqipëri është 30 euro, kundrejt 200 euro në Maqedoninë e Veriut, 100 euro në Serbi, 180 euro në Kosovë dhe 400 euro në Bashkimin Europian).

Por, sektori, që zë me punë rreth 40% të të punësuarve në vend, është në ditë të vështira. Nga një vëzhgim i "Monitor" në terren, pesimizmi mbizotëron në të gjithë hallkat e zinxhirit bujqësor. Tregtuesit e lëndëve të para, si plastmasë, apo fidanë, pohojnë për një rënie të ndjeshme të shitjeve, si rrjedhojë e tkurrjes së investimeve, teksa borxhet që u kanë fermerët, kanë arritur në nivele të paqëndrueshme. Fermerët, që dikur u kthyen nga emigracioni dhe investuan paratë dhe njohuritë në ndërtimin e serave, tashmë si për ironi po ikin sërish në emigracion, pasi investimet po iu rezultojnë të dështuara.

Grumbulluesit e mëdhenj pohojnë se, produktet e nisura për eksport në janar të këtij viti ranë me 15-20%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 dhe jo për mungesë të kërkesës nga jashtë, por për shkak se është tkurrur prodhimi. I njëjti pesimizëm mbizotëron edhe në blegtori, teksa përpunuesit e qumështit kanë më leverdi të importojnë lëndën e parë nga jashtë.

Bujqësia gjithnjë ka qenë problematike në vend, si rrjedhojë e copëzimit të tokave, mungesës së ekonomisë së shkallës, informalitetit, problemeve me standardizimin dhe cilësinë e produkteve, përdorimin pa kriter të plehrave kimike dhe mospasjes së politikave të qëndrueshme zhvilluese.

Megjithatë, fermerët gjetën hapësira për të investuar, duke shfrytëzuar ato pak avantazhe që kemi, ku më kryesori është klima, që mundëson daljen në treg dy apo tre muaj më herët sesa fqinjët. Nga viti 2010 deri në vitin 2021, eksportet e zarzavateve u shumëfishuan, investime të shumta u bënë në përpunimin e tyre, si dhe prodhimet e produkteve të bulmetit u rritën.

Të gjitha këto investime, tashmë po rrezikohen. Një faktor është rritja e çmimeve të lëndëve të para që importohen. Faktori i dytë është i brendshëm dhe lidhet me ndryshimet fiskale, që hynë në fuqi këtë vit, të cilat erdhën në momentin më të pafavorshëm: vendosja e TVSH-së prej 10% për inputet bujqësore dhe heqja e skemës së kompensimit prej 6% të TVSH-së (që deri në 2019-n kishte qenë 20%).

Fermerët paralajmërojnë se rreth 30% e serave (që zënë një peshë të rëndësishme në bujqësi) rrezikojnë të falimentojnë. Heqja e rimbursimit të TVSH-së ka dëmtuar fermerin dhe ka rritur informalitetin, pasi tashmë, ata nuk kanë interes të deklarojnë.

Tregu është në amulli (shiko specialen në faqen e brendshme të revistës) dhe ekspertët e sektorit kanë shpresa se situata mund të përmirësohet vetëm nëse bëhen disa ndërhyrje si më poshtë:

- Të krijohet bursa e produkteve bujqësore, që do të bënte transparente çmimet e produkteve në vend, por edhe rajon.
- Të bëhet orientimi i prodhimit për t'u përshtatur me nevojat e tregut, që do të shmangte mbiprodhimin dhe hedhjen në kanal të produkteve
- Të rivendoset shërbimi i agronomisë, që do të garantonte cilësinë dhe do të nxirrte përgjegjësit, në rast se ka prodhime jashtë standardi
- Të bëhet subvencioni për njësi prodhimi, që përveçse do të ndihmonte direkt prodhuesit, do të ndikonte në formalizimin e sektorit.
- Të nxitet industria përpunuese, për t'i rritur vlerën e shtuar sektorit dhe të kanalizonte në përpunim prodhimet që nuk arrijnë të shiten. Një pjesë e programeve të IPARD (Instrumenti i Asistencës së Para – Aderimit) të shkojë për industrinë përpunuese.

Bujqësia kërkon vëmendje reale dhe jo thjesht sa për shfaqje, si në rastin e prezantimit të skemave të garancisë, apo entuziazmit për të mirat e "Open Balkan". Nëse sektori nuk arrin të bëhet konkurrues, Shqipëria, me peshën më të madhe në Europë në bujqësi, paradoksalisht rrezikon të kthehet në një importuese të madhe, ndërsa qytetarët do ta paguajnë me çmime më të shtrenjta.

Revista "Monitor"

Nga 1 marsi do të rriten përsëri çmimet e bulmetit, arsyet

Nga 1 marsi do të rriten sërish çmimet e produkteve të bulmetit.

Shtrenjtimi do të ndikohet nga shtimi i kostos për të çmimeve më të larta të naftës, energjisë, plastikës dhe heqjes të skemës të TVSH-së të kredituehme 6% që nisi zbatimin nga 1 janari 2022.

Për shkak të rritjes së kostos nga këto faktorë, përfaqësuesi i kompanisë "Lufra", Luis Ndreka tha për Monitor se tashmë kompania ka lajmëruar që nga 1 Marsi çmimet do të rriten 10%.

"Ne kemi bërë një lajmërim në fillim të muajit Shkurt që do të rrisim çmimet në fillimin e muajit Mars, sepse kemi kontrata të cilat duhet t'i respektojmë. Çmimet do të rriten me rreth 10%, sepse kostot janë rritur shumë. Çmimi për lëndën e parë është rritur mjaft, duke rritur koston e qumështit të prodhuar nga fermerët. Po ashtu janë rritur shumë kostot e lëndëve plastike në tregun botëror, çka është reflektuar në Shqipëri. Po ashtu çmimi i energjisë elektrike po ndikon direkt te kostot, pasi në industrinë tonë kërkohet përdorim i lartë i energjisë elektrike. Po ashtu edhe çmimi i naftës na ka ndikuar shumë".

Aktualisht përpunuesit po përballen me mungesë në gjetjen e qumështit të prodhuar nga fermerët e vegjël. Oferta në treg për qumësht është më e ulët sesa kërkesa për produkte bulmeti, çka po sjell që përpunuesit të përballen çdo ditë me presionin e fermerëve për rritje të çmimit.

Sajmir Begaj përfaqësuesi i kompanisë "Erzeni" pohoi për Monitor se heqja e skemës të TVSH-së të kredituehme pamundëson financiarisht përpunuesit për të grumbulluar qumësht me çmim më të shtrenjtë.

"Çmimi i qumështit nga fermerët për këtë vit është rritur rreth 10% më shumë se vjet. Pavarësisht rritjes të tij në presion të përditshëm nga fermerët për rritje të çmimit të qumështit, pasi edhe ata kanë shtim të kostove nga lëndët e para. Aktualisht po furnizohemi nga fermerët me qumësht 50 cent për litër, kur në Itali çmimi i qumështit nga fermat shitet me çmim 30 deri 40 cent për litër. Faji nuk është te përpunuesit e qumështit. Shteti pasi hoqi TVSH-në e kredituehme 6% duhet të jepte subvencione direkte për fermerët. Kjo është një kërkese e vazhdueshme e industrisë. Ne kemi kërkuar pagesa direkte për fermerin 10 lekë/litër. Nëse nuk është mundësia për zbatimin e subvencionit për litra qumësht të prodhuar, fermerit pavarësisht numrit të bagëtive, 6% të TVSH-së të rimbursueshme që u hoq nga 1 janari 2022".

Sipas z. Begaj prodhimi i qumështit ka krijuar rënie te fermerët e vegjël. "Shumë fermerë të vegjël që rrisin 1 apo 2 lopë po largohen në emigracion. Fermat e mëdha janë rritur, por numri i tyre është shumë më i vogël krahasuar me fermerët e vegjël, çka nuk arrin të ekuilibrojë sasinë e qumështit të prodhuar në treg. Çmimi i qumështit për këtë vit është rritur rreth 10% më shumë se vjet".

Për shkak të rritjes të çmimit të plastikës dhe inputeve të lëndëve bujqësore kompania "Erzeni" vjet nga 1 Korriku rriti 5% çmimet e produkteve të bulmetit. Më pas nga ndryshimet e çmimit të energjisë nga 9 lekë/kW në 33 lekë/kW e furnizuar në tregun e lirë dhe shtrenjtimit të çmimit të karburantit nga 1 janari 2022 u aplikuan sërish në treg rritje 5% të çmimeve.

Përpunuesit e qumështit pohojnë se rritja e mëtejshme e çmimeve do të penalizonte industrinë vendase, pasi në treg do të shiteshin më tepër produkte importi me çmim më të lirë. Për të kompensuar rritjen e lartë të kostove të riprodhimit kompanitë kërkojnë rishikimin e skemës të TVSH-së të kredituehme.

Skema Kombëtare financon 50% të kostove për certifikimin Global GAP

Certifikimi i prodhimeve bujqësore me "Global GAP", është një patentë për eksporte të sigurta dhe me vlerë të lartë.

Qeveria për të tretin vit radhazi do të vijojë të mbështesë certifikimin e produkteve bujqësore me standardet europiane, si faktor i rëndësishëm në nxitjen e eksporteve të sigurta "Made in Albania", drejt tregjeve ndërkombëtare.

Skema Kombëtare për mbështetjen e Bujqësinë 2022, me fonde nga buxheti i shtetit adreson subvencionimin e fermerëve për implementimin dhe certifikimin me Global GAP të produkteve bujqësore, në masën 50 % të vlerës totale të faturës tatimore.

Sipas kritereve të përcaktuara, në udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përfitojnë financim të gjithë fermerët që aplikojnë certifikimin Global GAP, jo më shumë se 175 000 lekë, në perime, fruta, rrush, ullinj dhe agrume, në sipërfaqe të mbjellë

jo më pak se 1 hektar dhe jo më shumë se 500,000 (pesëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 ha në fushë të hapur.

Skema Kombëtare e Mbështetjes për Bujqësinë 2021, kualifikoi përfitues të financimit mbi 100 subjekte që aplikuan për certifikimin "Global Gap".

Aplikimet në Skemën Kombëtare 2022 pritet të hapen së shpejti, ndërsa janë përcaktuar 5 skemat e subvencionimit për një sërë sektorësh.

Luleshtrydhja gjigante vendos rekordin e ri botëror të Guinness!

Fermeri izraelit Chahi Ariel ka rritur luleshtrydhen më të rëndë në botë, sipas rekordeve botërore Guinness. Me 289 gram, luleshtrydhja një fruti të zakonshëm të varietetit lokal Ilan, tha Nir Dai, një studiues në Institutin Volcani të Izraelit, ku u zhvillua soji.

ishte rreth pesë herë më e madhe se pesha mesatare e

Luleshtrydhja ishte 18 centimetra e gjatë dhe 34 centimetra në perimetër, sipas hyrjes së Guinness.

Ariel kishte shpresuar se do të ishte fitues kur panë se sa i madh po rriteshin frutat në fermën e tij familjare vitin e kaluar. Ai ka pritur konfirmimin se ishte një rekord ndërsa mbante si provë luleshtrydhen gjigante në frigorifer.

Moti i pazakontë i ftohtë në fillim të vitit 2021 ngadalësoi procesin e pjekjes së luleshtrydhes, duke e lejuar atë të vazhdojë të fitojë peshë, sipas faqes së internetit të librit të rekordeve.

Rekordi i mëparshëm mbahej nga një fermer japonez, i cili zbuloi një luleshtrydhe prej 250 gramësh në korrjen e tij në 2015. CNN

MEKANIZIM

Rinovimi i mekanikës bujqësore, nevojë për ta bërë fermerin konkurrues në tregun rajonal

- Braktisja masive nga të rinjtë, e veprimtarisë dhe pronave në zonat rurale, zgjidhja: Programe afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, për rritjen dhe intesifikimin e mekanizimit, inovacionit dhe dixhitalizimit në bujqësi dhe në të gjithë sektoret e Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri.

- Fermerët në Shqipëri disponojnë 1.5 traktorë për 100 ha tokë bujqësore, Maqedonia e Veriut për të njëjtën sipërfaqe disponon 4 herë më shumë traktorë se Shqipëria, BE 6 herë më shumë, kurse Italia 8 herë më shumë. Zgjidhjet janë lehtësitë fiskale dhe financimi përmes granteve dhe kredive me kushte lehtësues për importin e traktorëve, makinerive bujqesore, pajisjet për inovacionin dhe dixhitalizimin.

(Vijon nga numri i kaluar)

KASH dhe E.K.R. ka vlerësuar se kosto e naftës së prodhuar në vend, duke përfshirë edhe koston e përpunimit, llogaritet në rreth 400 $/ton. Në një analizë krahasuese, kosto e naftës së importuar është tre herë më e madhe se sa kosto e naftës së vendit.

Në rast se përdoret nafta e vendit për të përmbushur nevojat e bujqësisë, fermerët dhe subjektet e tjera që përdorin mekanikën bujqësore do të shpenzojnë 25 milion $ në një vit bujqësor, pra përkatësisht ulen kostot e fermerëve me 75 milion dollar në një vit bujqësor. Kjo shumë e kursyer mund të investohet nga fermerët në përmirësimin e kushteve dhe teknologjisë së fermave. Rrjedhimisht, ky investim që do të ndikojë ndjeshëm në hapjen e vendeve të reja të punës në këto zona, në uljen e kostos së produkteve, në rritjen e shpejtë të prodhimit dhe në reduktimin e varfërisë. Gjithashtu, është e rëndësishme të vihet në duke se këto fonde të fermerëve që aktualisht dalin jashtë Shqipërisë sipas skemës se re nuk do të dalin dhe do ndikojnë edhe në përmirësimin e raportit import–eksport, duke i dhënë një ndihmë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme banorëve që jetojnë në zonat rurale.

Efiçenca e ulët e mekanikës ekzistuese bujqësore

Situata aktuale

Sipas studimeve të KASH dhe E.K.R. fermerët në Shqiperi posedojnë rreth 8683 traktorë, nga të cilët vetëm 5308 prej tyre janë në gjëndje pune. Këto traktorë janë në gjëndje të amortizuar për shkak të viteve të gjata të përdorimit të tyre. Mbizotërimi mekanikës bujqësore të vjetër rrit koston e mirëmbajtjes për shkak të nevojës për shërbime më të shpeshta dhe gjithashtu, rrit edhe kosot e operimit për shkak të konsumit më të madh të karburantit.

Në vizitat në terren të ekspertëve të KASH dhe E.K.R. ka rezultuar që shumica e mjeteve bujqësore nuk janë të regjistruara në drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor dhe rrjedhimisht, nuk janë të pajisura me targa dhe me leje qarkullimi. Gjithashtu, edhe në rastet kur janë të regjistruar pronarët e mjeteve bujqësore nuk përmbushin detyrimet ligjore për kontrollin periodik teknik të mjetit. Si pasojë e moszbatimit të dispozitave të Kodit Rrugor dhe të akteve në zbatimit të tij, këto mjete bujqësore përdoren në zona të kufizuara të cilat nuk kontrollohen nga agjentët e policisë rrugore. Kufizimi apo pamundësia e qarkullimit lirisht nga njëra zonë në tjetrën e këtyre mjeteve sjell për pasojë uljen e rendimentit të shfrytëzimit të tyre dhe rritje të kostove të zotërimit të mjeteve bujqësore.

Për shkak të situatës së tranzicionit politiko-ekonomik të 30 viteve të fundit, shumë nga poseduesit e mjeteve bujqësore janë në pamundësi objektive për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga aktet e dala në zbatim të Kodit Rrugor për regjistrimin e mjeteve bujqësore, për shkak se nuk kanë të paktën një nga dokumentet e nevojshme për regjistrimin e mjevete.

Zgjidhja e propozuar

Duke marrë në konsideratë që këto mjetë është e nevojshmë të regjistrohen dhe të kontrollohen periodikisht në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor, KASH dhe E.K.R., me qëllim rritjen e eficesës së përdorimit të mekanikës bujqësore, propozon formalizimin dhe regjistrimin e këtyre mjeteve nëpërmjet ndërhyrjes në Kodin Rrugor dhe në Rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 (i ndryshuar).

Nëpërmjet ndryshimeve ligjore të propozuara, kërkohet që gjatë një periudhe tranzitore 2 vjeçare, të thjeshtëzohet lista e dokumenteve të nevojshme për të regjistruar mjetet bujqësore me qëllim krijimin e kushteve poseduesve të mjeteve bujqësore të regjistrojnë mjetet e tyre. Në këtë mënyrë, mjetet bujqësore do të perdoren në efiçencë të plotë duke ofruar shërbimet e tyre në zona bujqësore të ndryshme, do rritet konkurenca ndërmjet poseduesve të mjeteve bujqësore dhe rrjedhimisht do të ulet çmimi që paguajnë fermerët për këto shërbime. Gjithashtu, nëpërmjet formalizimit të mjeteve bujqësore, pronarët e tyre kanë mundësi t'i vendosin ato lirisht nëqarkullimin juridiko-civil, si dhe së fundmi, mjetet bujqësore, duke qenë të regjistruara do t'i nënshtrohen periodikisht kontrollit teknik. Si pasojë, mjetet bujqësore që nuk plotësojnë kushtet teknike për qarkullimin rrugor do të dalin jashtë përdorimit dhe poseduesit e tyre do të jenë të detyruar për të zotëruar mjete bujqësore të reja. Në këtë mënyrë përmbushet qëllimi i ndërhyrjes së propozuar, pra rritet efiçenca e mekanikës bujqësore.

Modus

Qëllimi i mësipërm synohet të arrihet nëpërmjet dy akteve ligjore: një dispozitë tranzitore në Kodin Rrugor dhe një vendimi të këshillit të ministrave për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për formalizimin e mjeteve bujqësore.

Kodi rrugor, nëpërmjet dispozitës tranzitore, duhet të abrogojë, përkohësisht, dispozitat e Kodit Rrugor dhe të rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor në lidhje me dokumentet e kërkuara për regjistrimin e mjeteve bujqësore. Përjashtimi nga detyrimi për të paraqitur dokumentet e parashikuara nga Rregullorja e Kodit Rrugor duhet të jetë i zbatueshëm vetëm për mjetet bujqësore që kanë hyrë në Shqipëri përpara një date të caktuar, për shëmbull 1 janar 2010. Mjetet bujqësore të reja, si dhe mjetet që kanë hyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë pas kësaj date, prezumohen që i kanë kushtet për të përmbushur kërkesat e Kodit Rrugor për regjistrimin dhe kontrollin periodik të mjeteve. Siç u përmend më sipër, kjo nismë ndërmerret për shkak të pamundësisë së poseduesve të mjeteve ekzistuese për të përmbushur kërkesat për regjistrimin e mjeteve.

Gjithashtu, dispozita tranzitore duhet të autorizojë Këshillin e Ministrave, në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës, për të rregulluar, nëpërmjet një vendimi, kriteret, kushtet dhe procedurat për regjistrimin e mjeteve bujqësore.

Vendimi i Këshillit të Ministratave përvëç sa më sipër, duhet të parashikojë fushën e zbatimit, pra për mjetet bujqësore të paregjistruara dhe të futura në territorin e Republikës së Shqipërisë përpara një date të caktuar. Gjithashtu, duhet të parashikojë edhe organet që duhet të kryejnë identifikimin dhe nxitjen e poseduesve të mjeteve bujqësore për regjistrimin e tyre. Për këtë qëllim, KASH dhe E.K.R. propozon krijimin e një bashkëpunimi të posaçem ndërmjet drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, drejtorive rajonale të bujqësisë dhe shoqatave të fermerëve dhe agromekanizatorëve me qëllim asistimin dhe informimin e poseduesve të mekanikës bujqësore në plotësimin e dokumentacionit dhe aplikimin për regjistrimin e mjeteve bujqësore. Kjo zgjidhje, duke u bazuar në rolin e shoqatave të fermerëve dhe agromekanizatorëve, nxit poseduesit e mjeteve bujqësore të kryejnë regjistrimin dhe më pas kontrollin periodik të mjeteve.

Për më tepër, vendimi i Këshillit të Ministrave duhet të parashikojë edhe sanksione për ato posedues të mjeteve bujqësore që nuk pranojnë të kryejnë regjistrimin e tyre, duke filluar nga gjoba dhe deri në sekuestrimin e mjetit.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

AZHBR: Fermerët e serrave do të mbështeten me pagesa direkte për të mbuluar kostot e inputeve bujqësore

Flet drejtoresha e AZHBR, Eranda Selmanaj

Fermerët e serrave të prekur në kosto nga rritja e çmimeve të inputeve bujqësore në tregjet e huaja, për shkak të krizës nga pandemia COVID-19 pritet të subvencionohen me pagesa direkte në vlerën e 600,000 lekëve për dy sezone

të mbjellash.

Drejtoresha e AZHBR-së, Eranda Selmanaj, në intervistën për "Monitor Brief Insight" tha se subvencionimi nga shteti do të jetë me pagesë fikse për të mbuluar kostot e rritura të prodhimit nga ndryshimi i çmimeve të inputeve bujqësore. Në mbështetje të fermerëve, këtë vit do të zbatohet përsëri edhe skema për shpërndarjen e naftës falas.

Znj. Selmanaj pohoi se në ndihmë të aplikuesve për programin IPARD II, Masa 7, është ngritur seksioni specifik me qëllim shmangien e gabimeve teknike për plotësimin e formularëve standardë të akreditуar nga BE që kanë çuar në skualifikimin e menjëhershëm të kandidatëve.

Cilët janë sektorët që do të mbështeten me thirrjen e IPARD II?

Thirrja e IPARD II mbështet Masën 7, për sektorët e turizmit rural dhe të natyrës, si dhe punimet e artizanatit dhe industria e manifakturës. Në fokus janë dy sektorë, ai i turizmit rural dhe natyrës, si dhe sektori i artizanatit dhe manifakturës. Thirrja është e fokusuar në këta dy sektorë bazuar në prioritetet e qeverisë për të mbështetur zhvillimin e tyre, por edhe pasi në vitet e mëparshme, dhënia e granteve ka qenë e hapur për investimet në fermë dhe agropërpunim. Zbatimi i kësaj mase për këta sektorë mbështet gjithashtu edhe domosdoshmërinë e tyre për financim.

Cilat janë dokumentet që duhet të plotësojnë kompanitë e interesuara dhe kur përfundon afati i dorëzimit të tyre?

Kriteret që duhet të plotësojnë aplikuesit janë të publikuara edhe në udhëzuesin për aplikantët në faqen zyrtare të AZHBR dhe faqes së dedikuar për grantet e IPARD. Të interesuarit, fillimisht për të aplikuar, duhet të jenë të pajisur me NIPT aktiv të regjistruar në QKB, të kenë të përshkruar fushën e ushtrimit të aktivitetit të tyre me të cilin do të investojnë nëpërmjet programit IPARD.

Subjektet duhet të jenë të pajisura edhe me certifikatën e pronësisë, ose kontratë qiraje 10-vjeçare të regjistruar në hipotekë mbi truallin ku do të kryhet investimi. Po ashtu, duhet të paraqesin një plan biznesi sipas formatit standard të publikuar në aneksin për aplikantët, ku për investimet deri në 5,000 euro, projekti teknik është shumë i thjeshtë, më tepër është shpjegues dhe aplikuesit nuk i nevojitet kryerja e llogaritjeve financiare.

Për investimet me vlerë mbi 50,000 euro, plani i biznesit duhet të përmbajë në vlera pozitive indikatorët financiarë. Qëndrueshmëria financiare dhe rentabiliteti ekonomik i projektit janë mjaft të rëndësishme.

Për këtë arsye, projekti brenda periudhës 10-vjeçare duhet të gjenerojë të ardhura dhe të mbulojë kostot e investimit. Për plotësimin e dokumentacionit, nevojitet paraqitja e 3 ofertave të pavarura për çdo zë të investimit. Është vetë aplikanti që i merr ofertat në treg dhe përzgjedh një nga ofertuesit me të cilin do të kryejë punimet apo do të blejë pajisjet dhe makineritë për investimin që do të realizohet nëpërmjet programit.

Dokumentet e tjera që duhet të dorëzohet janë vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve dhe taksave që merren pranë organeve tatimore. Po ashtu kërkohet edhe plotësimi i dokumenteve specifike të certifikuara nga trupa teknike. P.sh. nëse aplikohet për grante në turizmin rural duhet të konfirmohet nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, që investimi i paraqitur do të

(Vijon në faqen 10)

STANDARDE NË BUJQËSI

Kujtesë për bujqësinë biologjike

Përgatiti Prof. Ass. Enver ISUFI
Instituti i Bujqësisë Biollogjike, Durrës

Këtë kujtesë të shkurtër po e prezantoj për ata agronomë e menaxherë që nga Ministria e Bujqësisë, Bashkitë, Njësitë Administrative e deri tek fermerët, të cilët akoma nuk janë mjaftueshëm të informuar me problematikat e bujqësisë biologjike në Shqipëri dhe prirjet e kohës

Prof. Ass. Enver Isufi

Ç'është bujqësia biologjike/ Organike/ Ekologjike?

Sipas Rregullores së BE-së këto terma janë sinonime.

"Bujqësia biologjike është ai sistem bujqësie, e cila përdor lëndë të para të listuara në atë që quhet "Lista pozitive", pra e bazës materiale si plehra, produkte të mbrojtjes së bimëve, farëra dhe fidana, të cilët lejohen të përdoren në bujqësinë biologjike.

Bujqësia biologjike ka standarde të miratuara, të cilat sigurojnë mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve, gjallesave të dobishme, larminë biologjike dhe mjedisin në përgjithësi, si ujin tokën, ajrin.

Në bujqësinë biologjike burime për ushqimin e bimëve dhe tokës janë:

• Plehrat organike, plehërimi i gjelbër, kompostimet e mbetjeve organike, plehrat organike që prodhon industria etj.

• Nuk lejohen plehrat kimike industriale të zakonshme si Nitrat, Ure, Superfosfat. Këto plehra prodhohen me burime të tjera të NPK (Azotit, Fosforit, Potasit/Kaliumit

Në mbrojtjen e bimëve lejohet një listë e gjatë insekticidesh, fungicidesh të cilat nuk janë helmuese për shëndetin e njerëzve.

• Preparatet e për mbrojtjen e bimëve me bazë bakteriesh, kërpudhash dhe virusesh, si dhe metodat bioteknike me feromone çorientuese të çiftëzimit të insekteve, janë disa nga metodat direkte.

Metodat agronomike, gjithshtu janë pjesë e strategjisë së mbrojtjes së bimëve në bujqësinë biologjike.

• Nuk lejohet përdorimi i herbicideve

• Nuk lejohen farëra dhe fidana dhe kafshë të ardhura nga modifikimet gjenetike.

Bujqësia bio quhet e tillë, kur certifikohet nga ekspertët e pavarur të inspektim-certifikimit.

Dokumenti që vërteton se produkti është biologjik, është certifikata e lëshuar fermës nga trupa e certifikimit, trupë, e cila paraprakisht duhet të jetë e regjistruar në Komisionin e Prodhimit Biologjik, pranë Ministrisë së Bujqësisë.

Termi "BIO" është edhe term juridik. Ky status mbrohet me ligj.

Keqpërdorimi i termit "Bio", shoqërohet me sanksione, sepse konsiderohet si mashtrim i konsumatorit.

Në vitin 2016 u miratua ligji i ri i bujqësisë biologjike në parlamentin Shqiptar

(Ligji i parë u miratua në vitin 2004).

Sa hektarë menaxhohen me bujqësi biologjike në botë, Europë, Ballkan, Shqipëri?

Në vitin 2021 raportohet se në shkallë botërore sipas standardit Bio menaxhohen 72 milion hektarë.

Bota: 1,5 % e sipërfaqes totale bujqësore menaxhohet sipas standardit biologjik.

Europa: 8,5 % e sipërfaqes totale bujqësore.

Ballkani: 1 % e sipërfaqes totale.

Shqipëria: nën 1 % e sipërfaqes totale bujqësore është e certifikuar si biologjike.

Objektivi i BE-s deri në vitin 2030, është që bujqësia biologjike të zërë 25 % të sipërfaqes totale bujqësore.

Cilat janë dokumentet më të rëndësishëm në bujqësinë biologjike në Shqipëri ?

1. Ligji kombëtar i bujqësisë biologjike
2. Standardi i bujqësisë bio dhe lista pozitive e inputeve
3. Dokumenti i "Planit të Veprimit Kombëtar" për bujqësinë biologjike

Cilat janë institucionet dhe infrastuktura kryesore në bujqësinë biologjike në Shqipëri?

1. Komisioni shumëdisiplinor i bujqësisë biologjike pranë Ministrisë së Bujqësisë (KPB)
2. Shërbimi Këshillimor Publik (në Qarqe dhe Bashki)
3. Instituti privat i Bujqësisë Biologjike (ibb), (Durrës)
4. Trupa private e certifikimit "Albinspekt" (Tiranë)
5. Shoqata Shqiptare e Marketingut (Tiranë)
6. Fermerët biologjikë kudo në Shqipëri
7. Rrjeti i pikave të shitjes së produkteve biologjike
8. Fermerët që eksportojnë produkte biologjike
9. Në Minstrinë e Bujqësisë ka një person me kohë të kufizuar, i cili mbulon edhe problemet e bujqësisë biologjike

Çfarë produktesh biologjike eksporton Shqipëria?

- Shqipëria ka një zë të mirë në tregun e huaj për vajin e ullirit, bimët mjekësore, produktet e pyllit.

A mbështetet nga ana financiare bujqësia bio në Shqipëri?

- Po. Fermat me certifikatën "në kalim bio viti i parë" marrin 100.000 lekë të reja

Fermat me certifikatën "viti i dytë në kalim bio ", marrin 150.000 lekë

Fermat e certifikuara "viti tretë, plotësisht biologjike» marrin 200.000 lekë.

Certifikimi i fermave të regjistruara si ferma bio në kalim ose si ferma bio e plotë kryhet çdo vit.

Kur fermeri dorëzon certifikatën në zyrat e AZHBR-së i dërgohen në numrin e tij të llogarisë shuma e lekëve sipas statusit që ka ferma.

Cilat janë hapat që ndiqen që nga regjistrimi i fermave si ferma biologjike, deri në certifikim?

• Hapi i parë: Fermeri bën kërkesë në zyrën e bujqësisë përkatëse, se fermën e tij do ta kalojë në fermë biologjike. Në momentin e regjistrimit të fermës si fermë e vitit të parë në kalim, nuk i kërkohet certifikatë, sepse ai sapo ka filluar këtë procedurë prodhimi.

(Këtë qartësim e përmenda, sepse padrejtësisht fermerëve qysh në fillimin kur regjistrohet si fermë bio, u kërkohet certifikatë. Certifikata mund t'u kërkohet fermerëve që janë në vitin e dytë dhe të tretë të prodhimit biologjik. Ferma e vitit të parë e merr certifikatën në fund të sezonit bujqësore, jo kur ai miratohet si fermë bio në kalim e vitit të parë.

• Hapi i dytë: Agronomët e zonës vizitojnë fermën për të vlerësuar nëse ferma ka ase jo, kushte për prodhimin e produkteve biologjike (pra faza e analizës së rriskut)

• Hapi i tretë: Fermeri lidhet më këshillatrin, trajnohet dhe merr të shkruar teknikat e prodhimit biologjik për bimët, produktet e të cilave kërkon t'i kalojë në produkte biologjike.

• Hapi i katërt: Ferma inspektohet për zbatimin e standardit biologjik. Nëse fermeri i ka zbatuar saktë rregullat e prodhimit biologjik, certifikuesi i jep certifikatën, sipas statusit të fermës (Bio në kalim viti i parë, ose bio në kalim viti dytë, ose bio i plotë viti tretë)

Fermeri ka të drejtë të vendosë termin "Produkt Bio", vetëm pas vitit të tretë të certifikimit.

• Hapi pestë: Nëse fermeri ka aplikuar për subvencione, dorëzon certifikatën në zyrat e AZHBR-së dhe kjo zyrë i dërgon lekët në llogarinë bankare të fermerit.

Çfarë do të ishin punët më urgjente për bujqësinë biologjike?

1. Fillimi i punës për të përshtatur ligjin e vitit 2016, sipas Rregullores së re të BE-së (2018 /848)
2. Fillimi i punës për hartimin e planit të veprimit të bujqësisë biologjike për vitet 2022 deri në 2027.
3. Akordimi i një fondi për shërbimin këshillimor, botimet dhe kërkimet në fermë për bujqësinë biologjike.
4. Emërimi i një personi me kohë të plotë, i cili të mbulojë dhe të kordinojë aktorët e bujqësisë biologjike në Shqipëri.
5. Përcaktimi i një fondi vjetor për bujqësinë biologjike.
6. Planifikimi i shtimit të numrit të fermave biologjike për çdo Bashki dhe Njesi Administrative.

Përfundoi me sukses disbursimi 100 % i fondeve grant prej 94 milion euro përmes Programit IPARD II. Parashikohet rritje e ndjeshme e buxhetit për Programin e ri IPARD III në 146 milion euro grant

(Vijon nga faqja 3)

energjinë e rinovueshme dhe ekonominë rrethore.

• Disa veprime në këtë masë do të kontribuojnë gjithashtu në përforcimin e pozitës së fermerit në zinxhirin ushqimor, duke i inkurajuar ata të bashkëpunojnë në zinxhirët e furnizimit të shkurtër dhe të prodhojnë produkte me vlerë të shtuar më të lartë.

Sektorët

• Grumbullimi, ruajtja dhe përpunimi i qumështit,

• Therja e kafshëve dhe përpunimi i mishit,

• Përpunimi i pemëve dhe perimeve,

• Përmirësimet në sektorin e verës dhe BAMs.

Investime në përpunim dhe marketing

• Të gjitha kanë për qëllim azhurnimin e standardeve të higjienës dhe mjedisit, rritjen e aftësisë konkurruese të përpunuesve të ushqimit, prezantimin e teknologjive të reja dhe sistemeve të cilësisë, përdorimin e energjisë së ripërtëritshme.

• Prioriteti i jepet investimeve:

• Vendosja e sistemeve të sigurisë ushqimore;

• Trajtimi i mbeturinave, pastrimi i ujit dhe përdorimi i produkteve nga mbeturinat;

• Teknologjitë e energjisë së ripërtëritshme;

• Arritja e ndërmarrjes me standardet përkatëse të BE-së

Masa Agro-ambjentale dhe bujqësia organike

• Objektivi i përgjithshëm i masës agro-mjedisore është të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore shqiptare dhe të zvogëlojë ndikimet negative nga aktiviteti bujqësor;

• Kjo gjë do të arrihet përmes një sërë skemash pilot në mënyrë që të fitohet përvojë praktike për përdorimin e një programi të plotë agro-mjedisor

Skemat Pilot

• Skema e Bujqësisë Organike;

• Ruajtja e racave lokale të ripërtypësve të vegjël (dhi dhe dele);

• Mirëmbajtja e ullishtave tradicionale

Zbatimi i strategjive lokale të zhvillimit - qasja LEADER

• Zbatimi i qasjes LEADER synon:

• Të përmirësojë zhvillimin e komunitetit,

• Të rrisë kapitalin social dhe

• Të kontribuojë në përmirësimin e situates ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore të zonave lokale, duke

• Angazhuar një gamë të gjerë partnerësh privatë dhe publik multi-sektorial dhe duke vlerësuar burimet e komunitetit në niveli lokal.

Zbatimi në Infrastrukturën Publike Rurale

• Objektivi i përgjithshëm është të mbështesë zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, duke çuar në një rritje të, qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse përmes zhvillimit të infrastrukturës fizike;

• Lehtëson zhvillimin e biznesit dhe komunitetit, në zhvillimin dhe punësimin në zonat rurale.

Sektorët

• Infrastruktura primare urbane;

• Rrugët e brendshme; furnizimi me ujë-kanalizimi;

• Trajtimi i ujërave të ndotura;

• Qendra shëndetësore;

• Objekte arsimore (shkolla, kopshte);

• Objekte social-kulturore sociale; etj;

Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit

• Objektivi:

• Të promovojë sipërmarrjen në zonat rurale përmes zhvillimit të një sërë aktivitetesh biznesi në mënyrë që të sigurojë mundësi për të ardhura shtesë dhe të frenojë shpopullimin

• Mbështetje për: prodhimin alternativ të bujqësisë;

• Zhvillimi i zanateve;

• Ofrimi i shërbimeve për popullatën rurale;

• Turizmi rural;

• Prodhimin dhe shitjen e energjisë së ripërtëritshme;

• Prioriteti i jepet bashkëpunimit të fermerëve dhe investimeve në rajonet malore, investimeve në energji të ripërtëritshme dhe prodhim organik

Masa e Asistencës Teknike

• Asistenca teknike:

• Mbështet përgatitjen, menaxhimin, monitorimin, vlerësimin dhe aktivitetet e publicitetit në lidhje me Programin IPARD;

• Mbështet aktivitete të e Rrjetit Kombëtar të Zhvillimit Rural

• dhe ndërtimin e kapaciteteve për LEADER (LAGs)

Shërbimi Ekstensiv

• Rrit aftësinë konkurruese të sektorit agro-ushqimor, në mënyrë progresive në përputhje me standardet e BE dhe e përmirëson efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e prodhimit në fermë, i cili do të sigurojë një përgjigje më të mirë ndaj kërkesave për ushqim të sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm;

• Lehtëson zhvillimin e biznesit, rritjen dhe punësimin në zonat rurale, përmirësimin e pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës dhe tërheqjen e fermerëve të rinj;

• Kontribuon në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe nxit menaxhimin e qëndrueshëm

Masa për Pyjet

Kontribuojë në objektivat IPARD për lehtësimin e rritjes dhe punësimit në zonat rurale, duke kontribuar në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe duke nxitur menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore;

Plotëson zbatimin e parimeve kryesore të Axhendës së Gjelbër për Ballkanin perëndimor.

Sektorët

• Pyllëzimi;

• Agropylltaria;

• Parandalimi i dëmtimit të pyjeve nga zjarret në pyje;

• Përmirësimi vlerës mjedisore të ekosistemeve pyjore

KËSHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

SHOQATAT ANËTARE

AVALB | FEDINVEST | BKFSH | EKR | IBMA | HABA | AOA | UPM | LEAA | ADAMA | ABA | SHGF | ALBAFLOR

SHKPVF | RKUK | SVP | MSHKM | BIOADRIA | PPAM | SHT | UOTSH | KEA | BIOPLANT | ADAD | PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA | DURRESI | FIERI | ELBASANI | SHKODRA | DIBRA

LEZHA | GJIROKASTRA | KORÇA | BERATI | VLORA | KUKESI

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në
7 MILIONË
Lekë

FED invest

GJITHMONË FINANCË SOCIALE

KËNDI I EKSPERTIT

MASTITI - INFEKSION I GJIRIT

Mastiti është një infeksion bakterial që shkakton inflamacion të gjirit të kafshës. Mastiti përbën një nga problemet kryesore të fermave sot në mbarë botën dhe do të ekzistojë edhe në të ardhmen, për aq kohë sa është e vështirë të kontrollohen organizmat mjedisore, si një ndër faktorët e rëndësishëm që e shkaktojnë mastitin.

Problemet që sjell mastiti

Mastiti krijon probleme me:

- Uljen e prodhimit;
- Ndryshimin e përbërjes së qumshtit, duke shkaktuar probleme jo vetëm për fermat, por njëkohësisht edhe për fabrikat e përpunimit;
- Ul jetën produktive të lopës së prekur;
- Ka kosto shumë të lartë për fermerin për kontrollin dhe kurimin e lopëve.

Faktorët që e shkaktojnë mastitin:

Mastiti shkaktohet nga faktore të ndryshëm, ku secili ka peshën e tij specifike.

1. 51% e faktorëve lidhet me mosrespektimin e praktikave rutine të para dhe pas mjeljes

2. 24% e faktorëve lidhen me mjedisin dhe strehimin:
   - Prania e bakterieve në tokë, jashtëqitje dhe shtratin e lopëve
   - Roli i mizave dhe insekteve të ndryshme të pranishme në ambjentet e qëndrimit të lopëve

3. 19% janë faktorë gjenetike:
   - Thitha të gjata – të cilat krijojnë probleme për futjen e e makinës mjelëse
   - Gjiri i rënë – është më i predispozuar për futjen e bakterieve
   - Rrjedhje e pavullnetshme e qumshtit nga thithat e lopëve

4. 6% nga makinat mjelëse:
   - Instalimi i gabuar
   - Mirëmbajtja e makinave
   - Pastrimi i makinave mjelëse: qumshti në përbërjen e tij ka yndyrë dhe kjo yndyrë vesh paretet e enëve dhe makinave mjelëse. Mospastrimi i rregullt i makinave mjelëse bëhet shkak për infiltrimin e bakterieve dhe krijimin e mastiteve.

Llojet dhe shenjat e mastiteve

Mastitet ndahen në:

a. Mastite klinike (të dukshme)

b. Mastite subklinike (të fshehta)

Shenjat e mastiteve të dukshme:

- Skuqje dhe mavijosje te gjirit
- Ngrohje e gjirit
- Dhimbje kur preket
- Refuzim i mjeljes ose vështirësi në mjelje
- Rënie e prodhimit
- Ndryshim në pamjen dhe përbërjen e qumështit

Mastitet e padukshme zbulohen me një test të thjeshtë:

CMT – Testi Kalifornian i Mastitit

CMT ka katër gropëza për marrjen e mostrës së qumështit, nga një për cdo thithë. Ka disa nivele të detektimit të mastitit, me hedhjen e reagentit:

- Nëse nuk kemi trashje të përzierjes – niveli i qelizave somatike është deri 100.000/ml – nuk ka mastit/infeksion;
- Nëse kemi një trashje të lehtë, e cila zhduket me lëvizje rrethore të pjatës – ngarkesa është 300.000/ml qumësht – pra ka mundësi të ketë prani të mastitit – është ende me dyshim;
- Në se trashja është e dukshme, por masa e trashur mund të lëvizë dhe nuk formon xhel të qëndrueshëm – kemi 900.000 qeliza somatike/ml qumësht – ka mastit të nivelit të dobët
- Në se trashja është e menjëhershme, masa bëhet si pelte dhe masa lëviz drejt qendrës së pjatës – ngarkesa është rreth 2.7 milion qeliza somatike/ml qumësht – kemi një nivel infektimi të konsiderueshëm.
- Në se masa e xhelit formohet menjëherë dhe qëndron në qendër të pjatës, edhe kur ndërpritet lëvizja rrotulluese – ngarkesa është mbi 8.1 milion – kemi infeksion shumë të rëndë dhe gjiri është tërësisht i dëmtuar.

Për të demonstruar testin kalifornian, mund të ndiqni videon në linkun e mëposhtëm:

https://youtu.be/BkkQ9TmiM94

Parandalimi i mastitit në gjedhë

Të parandalosh mastitin është shumë e lehtë dhe më pak e kushtueshme, se sa ta kurosh atë.

1. Pastrimi i thithave të lopës para mjeljes: për çdo lopë të përdoret një pece të pastër dhe e lagur me solucion dezinfektimi

2. Para vendosjes së makinës mjelëse, duhet te masazhoni gjirin për 2-3 sekonda, me qëllim që të aktivizoni gjendrat e qumshtit; të prisni një minutë e pastaj të vendosni makinat e mjeljes.

3. Hap shumë i rëndësishëm është dezinfektimi pas mjeljes, pasi ky dezinfektim shërben si filtër i kanalit të qumshtit. Të kihet parasysh që kanali i qumshit qëndron i hapur për 5-10 minuta pas mjeljes

4. Pas mjeljes, jepini ushqim kafshëve, për 5-10 minuta. Gjatë kësaj kohe ato do të qëndrojnë në këmbë për të konsumuar ushqimin dhe në këtë mënyrë mikrobet nuk do të mund të ngjiten lart në kanalin e hapur.

5. Pirja e vicave të mos bëhet nga gjiri i lopës, por me kova me biberon. Në këtë mënyrë jo vetëm ruhet gjiri i lopës, por njëkohësisht kontrollohet sasia që pijnë vicat, pasi kovat janë të shënuara me nivel vëllimi.

6. Të keni gjithmonë vëmendje tek pamja e jashtme e qumështit – në se ka pamje të ndryshme nga pamja normale, duhet të dyshoni menjëherë për prezencë mastitit.

7. Lopet e sëmura ose ato të infektuara me mastit, duhet të milen në fund të procesit të mjeljes dhe qumshti i marrë prej tyre nuk përdoret.

8. Kontroll i vazhdueshëm i makinave mjelëse:
   - a është nivel i rregullt vakuumi
   - a ka shkallën e duhur të pulsimit
   - pastrimi dhe dezinfektimi i makinave mjelëse, sipas protokollit përkatës.

9. Higjena personale e mjelësve:
   - Larja e duarve
   - Dorezat njëpërdorimshe
   - Rrobat e pastra

Parandalimi i mastitit kushton vetëm 5-7 lekë/lopë, ndërsa trajtimi i mastiteve ka shpenzime shumë të mëdha për medikamente, skartime të lopëve të sëmura dhe prishje të gjirit të kafshëve.

(Vijon nga faqja 6)

AZHBR: Fermerët e serrave do të mbështeten me pagesa direkte për të mbuluar kostot e inputeve bujqësore

zhvillohet sipas modelit tradicional të zonës apo dhënia e konfirmimit, nëse ky investim mund të zhvillohet në një zonë të mbrojtur.

Aplikuesit e projekteve për zhvillimin e turizmit rural duhet të plotësojnë kushtin për zhvillimin e investimit me limit deri 40 shtretër. Përmbushja e këtij kushti lëshohet nga Ministria e Turizmit, si dhe realizimi i tij duhet të jetë i përfshirë në projektin teknik dhe arkitekturor. Agjencia e Mjedisit duhet të lëshojë deklaratën që projekti për të cilin aplikohet në përfundim të investimit do të plotësojë standardet për shkarkimin e mbetjeve në mjedis.

Pjesa tjetër e dokumentacionit që plotëson aplikuesit do të provojnë qëndrueshmërinë financiare dhe mungesën e detyrimeve të pashlyera të subjektit. Të gjitha dokumentet do të dorëzohen sipas legjislacionit shqiptar dhe nuk ka kosto shtesë administrative. Një pjesë e dokumentacionit përfitohet edhe nëpërmjet portalit e-Albania dhe nuk paraqet vështirësi për gjenerimin e tyre. Thirrja do të mbyllet më datë 25 shkurt 2022.

A po hasin vështirësi subjektet për plotësimin e dokumentacionit, si po rezulton deri tani procesi?

Kjo është thirrja e programeve të IPARD për të cilën kemi marrë aplikime që në orët e para të mëngjesit të datës 10 janar, kur nisi procesi. Procedura përcakton se të gjitha aplikimet dorëzohen të mbyllura në zarf dhe hapen ditën kur drejtoria e përzgjedhjes së projekteve nis shqyrtimin e tyre. Dokumentacioni i dorëzuar vlerësohet teknikisht, për përmbushjen e kritereve të kandidatëve, kusht i kërkuar për t'u plotësuar nga BE.

Më pas vlerësimet e projekteve hidhen në sistem. Procedura është mjaft transparente. Në të kaluarën ka rezultuar që jemi hasur me shumë gabime formale nga kandidatët në plotësimin e dosjeve që në hapin e parë. Kjo ka sjellë që aplikuesi të skualifikohet dhe dosja e tij të mos shqyrtohet më tej. Për këtë arsye, këtë vit në fokus të zbatimit të programit IPARD është ngritur seksioni specifik për orientimin e aplikuesve me qëllim evitimin e gabimeve formale që shpesh ndodhin për plotësimin e formularëve standardë të akreditуar nga BE, të cilat janë të detyrueshme të plotësohen.

Sa do të jetë përfitimi monetar për projektet fituese?

Në aplikim për përfitim granti nga thirrja e IPARD 2, Masa 7, pranohen projektet me kosto nga 10,000 euro deri në 400,000 mijë euro. Nëpërmjet programit do të financohet 65% e kostos së projektit ose në vlerë monetare e shprehur granti i përfituar për financimi publik nis nga 6,500 euro deri në 260,000 euro. Kostoja tjetër e mbetur për realizimin e investimit duhet të plotësohet nga aplikantët me buxhetin e tyre.

Cili do të jetë projekti i radhës së AZHBR dhe si do të vijohet të mbështeten fermerët?

Edhe këtë vit do të vijojmë me zbatimin e skemave mbështetëse kombëtare nga buxheti i shtetit. Buxheti në vlerën e 3,2 mld lekëve që do të disbursohet brenda vitit 2022 për fermerët është 3-fish më i lartë se vitet e kaluara.

Së pari, skema kombëtare përfshin pagesat direkte për fermerët nëpërmjet aplikimeve nga e-Albania, sipas parimit për zero dorëzim dokumentacion. Dokumentacioni i nevojshëm për të verifikuar plotësimin e kritereve që gjenerohet online nëpërmjet portalit. Vetëm për fermerët që shpallen fitues iu kërkohet dokumenti origjinal për certifikatën e pronësisë.

Në fokus të skemës kombëtare janë edhe subvencionet që për herë të parë do të mbështesin sektorin e peshkimit dhe mbulimin e kostove të inputeve bujqësore për serrat. Ka përfunduar hartimi i vendimit dhe udhëzimit përkatës për përcaktimin e kritereve nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë që pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Pas miratimit të tyre do të nisë edhe faza e aplikimeve dhe shpërndarjes të subvencioneve, sipas kritereve që do të përcaktojë vendimi dhe aktet nënligjore. Procedura do të jetë e thjeshtë dhe pagesat ndaj fermerëve do të jenë direkte. Vitin e kaluar u zbatua, për herë të parë, skema e mbështetjes me naftë falas për fermerët që do të vijojnë zbatimin edhe këtë vit, duke përfshirë, për herë të parë, rimbursimin e barrës fiskale edhe për fermerët që kultivojnë ullirin.

Jemi duke punuar për zhvillimin e programit IPARD III, që është vijim i programit IPARD II. Programi është dërguar pranë strukturave të Komisionit Europian dhe presim miratimin e tij. Në raport me IPARD II në këtë program parashikohet të përfshihen 5 masa shtesë dhe me buxhet 50% më të lartë. Totali i fondit me programin IPARD II ishte rreth 94,6 mln euro.

Nga takimet me fermerët në Lushnjë, shumë prej tyre ngrenë shqetësimin e rritjes së kostove. Çfarë parashikon masa në mbështetje të subvencioneve për inputet bujqësore të serrave?

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka qenë çdo ditë prezente në terren dhe ka dëgjuar shqetësimet e fermerëve dhe për këtë arsye parashikojmë që për herë të parë, të përfshijmë zbatimin e skemës mbështetëse për serrat për të adresuar problemet e tyre, duke i dhënë përparësi rritjes së kultivimit në serra.

Më tepër janë të prekur fermerët e serrave nga rritja e çmimeve të inputeve bujqësore në tregjet e huaja. Por probleme janë hasur edhe me shitjen e fidanëve në tregun vendas, që në disa raste tregtohen nga individë që i kultivojnë në kushte shtëpie, të pacertifikuara. Masa mbështetëse e propozuar synon gjurmueshmërinë e të gjithë procesit për të marrë masat e duhura në zgjidhjen e problemeve dhe vazhdimin e kultivimeve në serra.

Konkretisht për prodhimet në serra do të jenë dy masa mbështetëse, një në formën e pagesave direkte, ku fermeri do të aplikojë nëpërmjet portalit e-Albania dhe më pas do të dorëzojnë faturat e inputeve bujqësore, farës, fidanit të bimëve, pesticideve të përdoruara për mbjelljet e dy sezoneve të serrave. Pas verifikimit që ne do të kryejmë që në serë është kultivuar kultura e dorëzuar me faturë do të rimbursohet me vlerë fikse për sipërfaqen e mbjellë.

Është propozuar që vlera e kompensimit për një sezon të kultivimit në serë të jetë 300,000 lekë. Fermerët parashikohet të përfitojnë rimbursimin deri në dy sezone të mbjellash me vlerë 600,000 lekë, për të mbuluar të gjitha kostot e inputeve bujqësore. Procedura e aplikimit parashikohet të jetë e thjeshtë. Do të aplikohet nëpërmjet e-Albania me NIPT-in e fermerit.

Masa e dytë do të mbështesë investimet e reja që do të kryhen në serra me qëllim rritjen e sipërfaqeve së tokës së kultivuar në serra. 50% e vlerës së projektit do të mbulohet me grant nga buxheti i shtetit. Procedura e aplikimeve do të jetë e ngjashme me atë të programit IPARD, ku fermerët duhet të paraqesin dokumentacionin, që nga certifikata e pronësisë së tokës dhe lejet e nevojshme, fillon projekti dhe më pas disbursohet kompensimi.

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE LUSHNJE

MESAZHE PËR PRODHUESIT E PERIMEVE

Muaji shkurt karakterizohet nga temperatura të ulëta dhe kujdesi për perimerritësit në bujqësi duhet të jetë i madh. Punohet me përgatitjen e serrave që janë pa mbjellë. Kujdesi për ato që janë mbjellë gjatë muajve të mëparshëm. Punohet për mbjelljen e farave në farishte e me përgatitjen e fidanëve për perimet e fushës; ndërkohë që vazhdon puna për përgatitjen e ngastrave, me plugimet, plehërimet bazë, hapjen dhe mbajtjen në funksion të plotë të rrjetit kullues të ngastrës, etj. Po vazhdohet dhe me kryerjen e shërbimeve të tjera si kullim. Pra është periudhë shumë intensive me punë, ku sipas drejtimit të fermës mbillen serra, përgatiten ngastra në fushë për mbjellje, vilet prodhimi i gatshëm.

Aktivitetet kryesore të kësaj periudhe

Në serra: Me rëndësi është puna për përgatitjen e serrave për mbjelljet (kryesisht ato bostanoret), ku mbulimi me plastmasë dhe përgatitja e tokës janë proceset kryesore. Punimi i thellë i tokës (30-40 cm) dhe jo pluhurosja e saj me frezim sipërfaqësor, është veprim me interes për rritjen dhe zhvillimin e mirë të bimëve. Plehërimi bazë i serrave të mbështetet në plehun organik dhe më pas në plehrat baze kimike (NPK). Këshillohet që të tregohet kujdes për kryerjen e analizave kimike të tokës për të bërë bilancin e të ushqyerit të bimëve për ruajtjen e pjellorisë së tokës dhe mirëmbajtjen e saj. Hapja dhe mirëmbajtja e sistemit të kullimit mbetet detyrë e përhershme. Në zonat Lushnje, Fier, Berat etj një pjesë e mirë e serave janë mbjellë kryesisht domate, trangull patëllxhan, speca dhe vazhdon puna për mbjelljen e bimëve të tjera si bastanoret etj dhe vazhdohet me proceset e punës për perimet që janë mbjellë më herët. Duhet të merren masa për ti mbrojtur nga ngricat temperaturat e ulëta. Ka disa masa mbrojtëse: mbulimi i fidanëve të mbjellë me plasmasë ose agrotekstile në formë tuneli brenda serrës; vendosja e një plasmasi të dytë anës serrës; instalimi i pajisjeve ngrohëse në rast emergjence. Këto janë masa për të ruajtur të ngrohtin që fitohet ditën si rezultat i efektit serrë, dhe të mos lejohet futja e të ftohtit deri tek bimët e mbjella. Disa serra aktualisht janë mbjellë me disa bimë dimërore, si sallatë, spinaq, erëza, etj., ku puna me ato vazhdon për kryerjen e shërbimeve dhe vjeljet. Me interes tek këto bimë është përdorimi i mbulesave tekstile (tesuto)..

Në fushë: Në bimët e mbjella në verë e vjeshtë, si lakra kokë, lule-lakra, brokoli, karrota, prasi, qepa, hudhra etj, vazhdohet me vjeljen e tyre.

Në fushë në zonën e ultësirës perendimore ka filluar e vazhdon mbjellja e bizeles, patates, spinaqit etj. Me farën e patates puna ka filluar më herët, duke bërë bulëzimin e saj në mjedise të ngrohta, si hangarë, tunele, etj.

Në zonën e ngrohtë ka filluar puna dhe duhet të vazhdojë për përgatitjen e ngastrave për mbjelljen e shalqirit të hershëm, të domates, specit, patëllxhanit, barbunjës, bathës, etj. Në parcelat ku ato që do mbillen, të tregohet kujdes për kryerjen e analizave kimike të tokës për të bërë bilanc të ushqyerit të bimëve për ruajtjen e pjellorisë së tokës dhe mirëmbajtjen e saj. Veçanërisht në këtë stinë reshjesh, krahas punimit të mirë të tokës, të tregohet kujdes për kullimin, i cili jo vetëm mbron tokën nga erozioni e dëmtimi, por dhe lejon kryerjen e shpejtë të punimeve përgatitore dhe mbjelljeve të hershme.

Për perimet e hershme në fushë, gjatë muajit shkurt të filloj puna me mbjelljen e farërave në farishte dhe përgatitjen e fidanëve për prodhim të hershëm të shalqinit, domates, specit, patëllxhanit, pjeprit, sallatës, etj.

Drejtoria e Teknologjive të Perimeve: QTTB-Lushnje
E-mail: qttblushnje@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

REKOMANDIME PËR FERMERËT NË LIDHJE ME SHËRBIMET KRYESORE NË PEMËTARI PËR JAVËT NË VAZHDIM

Shkurti, muaji më i shkurtër i vitit, por për punët në pemëtari është muaj i ngarkuar me punë, pasi pemët në përgjithësi lënë fazën e qetësisë dimërore dhe fillojnë aktivitetin e ri vegjetativo-prodhues. Gjatë periudhës në vazhdim të këtij muaji, ndërhyrjet më të mundshme në pemëtore, janë mbjelljet e pemëtorëve të reja, ndërsa në pemëtoret ekzistuese, përfundimi i krasitjeve, aplikimi i trajtimeve fitosanitare dhe sipas rastit edhe punimet e tokës të shoqëruara me shtimin e plehrave të domosdoshëm për të plotësuar nevojat e pemëtores.

1. Mbjelljet e reja

Mbjelljet e reja duhet të paraprihen nga një analizë e nevojave të tregut. Duhet të synohet në shtimin e atyre kulturave që kanë kërkesa në treg, duke specifikuar dhe kultivarët sipas kohës së pjekjes së tyre. Për mbjelljen e pemëtoreve të reja zgjedhja e kultivarit dhe e materjalit bimor janë aspektet më të rëndësishme. Gabimet që bëhen shpesh nga padija, në zgjedhjen e species, por mbi të gjitha të kultivarit dhe materjalit mbjellës (fidanit), janë me pasoja të rënda në ekonominë e fermës. Mbjellja e një kultivari të papërshtatshëm për kushtet e një zone të caktuar nuk është mangësi e materjalit mbjellës por e zgjedhjes që fermeri ka bërë, prandaj është e këshillueshme që kushdo që investon në pemëtari të jetë i kujdesshëm në zgjedhjet që bën. Çdo kultivar ka specifikat e veta, ka arealin e vet ku mund të shprehë më mirë potencialin e tij prodhues, ndërkohë që kushdo që nuk ka informacion për cilësitë e tyre mund të konsultohet me specialistët e fushës.

Krahas zgjedhjes së kultivarit, e rëndësishme është njohja e nënshartesës, e karakteristikave të saj dhe e ndikimit që ajo ka në funksionimin e unitetit me mbishartesën dhe në proceset jetësore të bimës. Në tregun e vendit tonë ka shumë mundësi zgjedhje dhe zgjidhje për fat të mirë në lidhje me nënshartesat e përdorura dhe kombinimet me nënshartesat, mjafton që fermeri të orientohet në subjektet e duhura.

Jo më pak të rëndësishme janë edhe aspektet teknike të realizimit të mbjelljeve të reja, që lidhen me përgatitjen e tokës, distancat e mbjelljes, piketimin dhe mbjelljen.

Punimet përgatitore dhe punimet e thella të tokës, janë baza, për krijimin e kushteve optimale të fidanave të mbjellë, për zhvillimin e mirë tyre dhe për t'i dhënë jetë një pemëtore efektive. Në rast se ato nuk janë kryer më parë (punimet qilizëm në gusht janë më të rekomanduara) në ditët në vijim mund të realizohen për ato zona bujqësore ku afatet kohore të mbjelljeve e lejojnë. Në terrene ku nuk është e mundur punimi i gjithë terrenit, zgjidhja është hapja e gropave me dimensione më të mëdha.

Një rregull i rëndësishëm për të ndjekur gjithmonë gjatë mbjelljeve, është thellësia e mbjelljes të bimës. Qafa e rrënjës duhet të jetë në të njëjtin nivel siç është në vazo/qeskë, apo pozicioni që ka pasur në tokë një fidan me rrënjë të zhveshura. Nuk duhet të vendoset as më thellë dhe as të zbulohet.

Plehrat që hidhen zakonisht në gropë gjatë mbjelljes së fidanit, duhet të përzihen mirë me dheun, të mos teprohet me sasitë, plehrat organike duhet të jenë të kalbura mirë, kujdesi duhet që fidani të mos bjerë në kontakt direkt me to, veçanërisht me plehrat kimike.

Ngjeshja e tokës rreth fidanit gjatë mbjelljes, për të siguruar kontakt të mirë të rrënjëve me tokën, është një aspekt tjetër i thjeshtë në dukje, por i rëndësishëm në aspektin e ndikimit në zënien e fidanit. Ngjeshja më e mirë është ujitja e bimëve pas mbjelljes.

2. Krasitja e pemëve frutore

Në të gjitha pemëtoret ku nuk ka përfunduar krasitja, nuk duhet të ketë vonesa për realizimin e tyre. Duhen respektuar afatet optimale për kryerjen e këtij procesi sipas specieve të drufrutorëve dhe sipas zonave të kultivimit. Tashmë rreziku nga ngricat e javës që lamë pas, nuk përbën problem për të vijuar me krasitjet.

Krasitja e pemëve frutore është një operacion që konsiston në largimin e plotë ose të pjesshëm të lastarëve, rrënjëve ose të degëve, dhe nëpërmjet saj realizohen disa objektiva, ku mund të përmendim dhënien ose mbajtjen e formës së dëshiruar në funksion të përdorimit më optimal të dritës nga bima, rregullimin e raportit midis prodhimit dhe rritjes vegjetative, zëvendësimin e pjesëve të vjetra ose të dëmtuara nga sëmundje ose dëmtime nga faktorë të tjerë.

Sipas fazës së zhvillimit të bimës krasitjet ndahen në krasitje formuese, prodhuese dhe ripërtëritëse.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Drejtoria e Teknologjive të Pemëtarisë: QTTB-Vlorë
E-mail: qttbvlore@yahoo.com

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

PLEHËRIMI I AGRUMEVE

Sipas vjetarit statistikor të vitit 2020, agrumet zënë një sipërfaqe rreth 1488 ha në shkallë vendi. Rendimenti mesatar i agrumeve është 400 kv/ha kjo e përllogaritur për 1329 ha agrume në prodhim. Nevojat e konsumatorit për agrume aktualisht nuk plotësohen nga prodhimi vendas, kjo dikton shtimin e sipërfaqes së kultivuar përmirësimin e teknologjisë së kultivimit, futjen e kultivarëve me kapacitet të lartë prodhues etj.

Një nga faktorët që ndikon në rritjen e rendimentit të agrumeve është të ushqyerit me plehra organike dhe minerale. Nëpërmjet këtij mesazhi synojmë që të ofrojmë disa këshilla, mbi rëndësinë që kanë makro dhe mikroushqyesit te agrumet, sasinë (dozën) dhe kohën e përdorimit të tyre.

Për një rendiment prej 70 kg/rrënjë agrume, në një tokë me pjellori mesatare këshillojmë që dozat dhe periudha e përdorimit të lëndëve ushqyese të jetë si më poshtë:

Azoti

Azoti është një element i rëndësishëm për prodhimin e masës gjethore, rritjen e masës së frutave, si dhe asimilimin e proteinave në bimë. Përdorimi i tij në formë nitrike në doza të caktuara gjatë lulëzimit dhe frutifikimit mban shijen dhe aciditetin normal duke ulur nivelin e kalbëzimit. Agrumet kërkojnë në mënyrë të vazhdueshme azot, ku 50% e tij akumulohet në fruta.

Rekomandojmë përdorimin e 0.24 - 0.27 kg/rrënjë lëndë aktive me azot në periudhën e parë të rritjes dhe 0.3 - 0.5 kg/rrënjë lëndë aktive në periudhën e dytë të rritjes me plehra azotike.

Plehrat azotike përdoren para periudhës së lulëzimit herët në pranverë ose në muajin Shkurt – Mars në ½ e dozës rë rekomanduar dhe në periudhën Maj – Korrik (periudha e rritjes intensive vegjetative dhe rritjes së frutave) përdoret ½ e dozës së rekomanduar. Theksojmë që të rrisim efektivitetin e plehërimit me plehra azotike, plehërimi duhet shoqëruar me prashitje.

Fosfori

Është i rëndësishëm gjatë lulëzimit dhe formimit të frutave. Ai gjithashtu ndikon në hershmërinë e prodhimit, zhvillimin e mirë të sistemit rrënjor dhe në numrin e frutave. Rekomandojmë përdorimin e 0.08 - 0.09 kg/rrënjë lëndë aktive me Fosfor në periudhën e parë të rritjes dhe 0.25 -0.30 kg/rrënjë lëndë aktive në periudhën e dytë të rritjes me plehra fosforike.

Potasi

Sikurse azoti stimulon rritjen, rregullon sasinë e ujit në bimë, tolerancën ndaj streseve dhe rregullon procesin e transportit të asimilateve. Luan rol kyç në rritjen e sheqerit në fruta.

Rekomandojmë përdorimin e 0.19 - 0.21 kg/rrënjë lëndë aktive me Potas në periudhën e parë të rritjes dhe 0.22 - 0.25 kg/rrënjë lëndë aktive në periudhën e dytë të rritjes me plehra potasike.

Koha më e përshtatshme për përdorimin e plehrave fosforike dhe atyre potasike është periudha e vjeshtës, në punimin e tokës ose në periudhën e dimrit së bashku me plehun organik i cili përdoret në dozën 30-35kg/rrënjë.

Në plehërimin e agrumeve ka rëndësi dhe përdorimi i mikroushqyesve si Kalciumi, Magnezi dhe mikroushqyes të tjerë të cilat në doza të vogla përdorimi por me impakt në kohën e diferencimit të sythëve si dhe në faza të tjera të rritjes dhe zhvillimit të agrumeve.

Kalciumi

Është i nevojshëm për zhvillimin e sistemit rrënjor të fidanëve, jep një zhvillim të mirë te masës vegjetative, rrit cilësinë e frutave duke i bërë më të qëndrueshëm ndaj kalbëzimit.

Rekomandohet të përdoret në dozën 170gr/kv në trajtën e plehrave kristalore.

Magnezi

Është i rëndësishëm për të përmirësuar cilësinë e frutit dhe merret kryesisht pas lidhjes së frutit. I jep fortësi tulit të frutit. Rekomandohet të përdoren 50gr/kv. Në agrume mund të përdoret dhe plehërimi gjethor duke spërkatur kurorën me tretësira të kripërave të makro dhe mikroelementëve.

Këshillojmë fermerët që për të siguruar rendimentin e planifikuar dhe të shëndetshëm në agrume duhet të bëjnë testimin periodik të treguesve fizikë dhe kimikë të tokës në Laboratorin Analitik të Tokës në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë. Mbi bazën e rezultateve të analizave të tokës specialistët agronomë do të ofrojnë dozat e nevojshme për makro dhe mikroushqyes në kultivimin e agrumeve.

Përgatiti: Zhaneta Hasani, Shpëtim Tafaj

Drejtoria e Shërbimit të Tokës dhe Ujërave;
QTTB-Fushë Krujë: E-mail:qttbfushekruje@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

MBI AGROTEKNOLOGJINË E MBJELLJES DHE KULTIVIMIT TË BIMËVE AROMATIKE MEDICINALE (BAM)

Punimet përgatitore të tokave (21-25cm) diskime, ferzime, etj dhe plehërimet organike

Tokat të cilat janë punuar në vjeshtë janë të gatshme për të ndërhyrë me punime pergatitore. Për arësye të ndryshme mund të ketë siperfaqe toke që janë planifikuara të mbillen me bimë aromatike medicinale (BAM) në Pranëverën e 2022, por që nuk janë punuar deri tani. Ky muaj është afati i fundit që të kryhen këto punime dhe bashkë me to të hidhen dhe 300 kv plehra organike duke e përmbysur në tokë krahas punimit.

Plehërimet kimike në prodhimin konvencional

Në ato sipërfaqe që është planifikuar të merret prodhim konvencional gjatë këtij muaji duhet të bëhet plehërimi me plehëra kimike. Për këtë qëllim duhet të përdorur DAP i cili në përmbajtjen e tij të ketë më shumë element të Fosforit dhe të Kaliumit dhe sa më pak Azot.

Kullimi i tokave të punuara

Siperfaqet e tokave të punuara në vjeshtë duhet që të bëhet kullimi i tyre, duke mbajtur pastërt kanalet kulluese, ose duke i hapur menjëherë ato aty ku nuk janë hap deri tani. Në këtë mënyrë bëjmë të mundur që të mbrojmë tokën nga erozioni dhe të kemi një tokë të pergatitur shumë më mirë për mbjelljet e pranverës.

Kullimi i parcelave të mbjella me BAM; pastrimi i gurëve në tokat gurishtore; sistemime, pastrime eleminim mbeturinash

